

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7331 E hënë 23 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Një komandant serb nga lufta e Kosovës do të japë mësim në Akademinë Ushtarake të Beogradit. Qeveria nuk shqetësohet nga fakti, që ai ka qenë në burg... Vijnë në faqen 20

Nga SONJA BISERKO
Serbi, një kriminel luftime si docent



Opinion **Ditës**
Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë regjistruan në datën 19 tetor ndërhyrjen më flagrante në punët e brendshme të Shqipërisë nga qeveria e Athinës këto dhjetë... Vijnë në faqen 21

Nga SHABAN MURATI
Nuk bisedohet me Greqinë në këto kushte



Nezar Seiti dhe Armando Koçerri, dje në gjykatë

Trafiku i drogës, gjykata lë në burg dy miqtë e Habilajve, policë të përfshirë

Dosja në prokurori, në 4 vjet Habilajt trafikuan 30 tonë kanabis drejt Italisë

Grupi kriminal i drejtuar dhe i organizuar nga vëllezërit Habilajt dyshohet se ka trafikuar nga brigjet shqiptare drejt atyre italiane rreth 30 tonë kanabis sativa. "ABC News" ka mësuar nga dosja sekrete e mbërritur në Prokurorinë e Krimeve të Rënda se këtë sasi të madhe droge, grupi kriminal i Moisi...

Në faqet 2-3

ÇFARË DUHET TË DINI PARA SE TË VENDOSNI TA PERFITONI KETË PAGESË

SI FITOHET PENSIONI I REDUKTUAR I PLEQERISE

Llogaritja sa ju del masa me shembuj konkretë. Sipas ndryshimeve ligjore, vitet e sigurimit në 2017-ën janë 36 vjet, rritja vjetore 4 muaj

PËR GRATË		PËR BURRAT	
Shekulli	Vitet e sigurimit	Shekulli	Vitet e sigurimit
1950	36	1950	36
1951	36	1951	36
1952	36	1952	36
1953	36	1953	36
1954	36	1954	36
1955	36	1955	36
1956	36	1956	36
1957	36	1957	36
1958	36	1958	36
1959	36	1959	36
1960	36	1960	36
1961	36	1961	36
1962	36	1962	36
1963	36	1963	36
1964	36	1964	36
1965	36	1965	36
1966	36	1966	36
1967	36	1967	36
1968	36	1968	36
1969	36	1969	36
1970	36	1970	36
1971	36	1971	36
1972	36	1972	36
1973	36	1973	36
1974	36	1974	36
1975	36	1975	36
1976	36	1976	36
1977	36	1977	36
1978	36	1978	36
1979	36	1979	36
1980	36	1980	36
1981	36	1981	36
1982	36	1982	36
1983	36	1983	36
1984	36	1984	36
1985	36	1985	36
1986	36	1986	36
1987	36	1987	36
1988	36	1988	36
1989	36	1989	36
1990	36	1990	36
1991	36	1991	36
1992	36	1992	36
1993	36	1993	36
1994	36	1994	36
1995	36	1995	36
1996	36	1996	36
1997	36	1997	36
1998	36	1998	36
1999	36	1999	36
2000	36	2000	36
2001	36	2001	36
2002	36	2002	36
2003	36	2003	36
2004	36	2004	36
2005	36	2005	36
2006	36	2006	36
2007	36	2007	36
2008	36	2008	36
2009	36	2009	36
2010	36	2010	36
2011	36	2011	36
2012	36	2012	36
2013	36	2013	36
2014	36	2014	36
2015	36	2015	36
2016	36	2016	36
2017	36	2017	36

(Në foto) Faksimile e tabelave për moshën e daljes në pension për burrat dhe gratë. Foto ilustruese

BASHA: NË PROTESTA

Agjentët e FBI në Tiranë, Rama e Xhafaj ua 'mbledhin' uniformave blu

Në faqet 4-5

PROVA PER QEVERINE

Vasili, Ramës: Kujdes me joshjet e telefonatat që u bën personave kyçë

Në faqen 6

SI NDODHI NGJARJA

Atentat në qendër të qytetit të Shëngjinit, plagosen rëndë dy të rinj

Në faqen 8

LISTA E PERDITËSUAR

Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës

Në faqet 18-19

NGA 29 TETORI, NJE PROGRAM NDIHME



Zyra konsullore: Studime në SHBA, ja 5 hapat që duhet të ndiqni

Në faqen 7

"Life Pages"/ Si të shpëtoni nga osteoporoza dhe këshillat çudibërëse me mjaltë e hudhër

Lumturi Mërkuri: Kanceri, mos neglizhoni mamografinë

Ministrja e Shëndetësisë: Paketë e re radioterapie për kancerin e gjirit

Nga VOLTIZA DURO

Në Shqipëri kanceri i gjirit është tumori që haset më shpesh tek gratë, me rreth 550 raste të reja çdo vit. Në një intervistë të dhënë për suplementin "Life Pages" të "Gazeta Shqiptare", mjekja Lumturi Mërkuri u bën



thirrje të gjitha grave që të ndërgjegjësohen dhe të bëjnë kontrollin e gjirit, sepse nëse arrijnë ta zbulojnë në fazat e hershme, mund të trajtohen. Çfarë është kanceri i gjirit? Kanceri i gjirit është një lloj tumori ku qelizat e gjirit rriten jashtë kontrollit...

Suplement

DOSJA "HABILAJ" HETIMET

Droga është transportuar me mjete lundruese, por edhe në rrugë ajrore

Dosja në prokurori, në 4 vjet Habilajt trafikuan 30 tonë kanabis drejt Italisë

Aktiviteti kriminal është kryer gjatë viteve 2013-2017

Grupi kriminal i drejtuar dhe i organizuar nga vëllezërit Habilaj dyshohet se ka trafikuar nga brigjet shqiptare drejt atyre italiane rreth 30 tonë kanabis sativa. "ABC News" ka mësuar nga dosja sekrete e mbërritur në Prokurorinë e Krimeve të Rënda se këtë sasi të madhe droge, grupi kriminal i Moisi Habilajt e ka trafikuar në brigjet e vendit fqinj gjatë viteve 2013-2017. Në këtë konkluzion kanë dalë hetuesit italianë, ku ky aktiviteti kriminal ishte kryer në harkun e katër viteve. Gjatë bisedave të përgjuara dhe të bëra publike tashmë nga gjykata e Katania, anëtarë të këtij grupi shqetësohen për sigurimin e mjeteve të shpejta lundruese me tre motorë, të cilat konsiderohen edhe si gomone oqeanike. Vetëm në dy aksionet e fundit të kryera në Itali e në Shqipëri, grupit që udhëhiqej nga Moisi Habilaj e Florian Habilaj dhe anëtarëve të tjerë Nezar Seiti, Meridian Sulaj e Armando Sulaj iu sekuestruan në total rreth 8 tonë drogë. Fillimisht, në zonë e Brindisit u kapën rreth 3.5 tonë kanabis dhe ishte dërguar nga banda "Habilaj" me mjete lundrues gjatë muajit shtator. Por, vijimi i aksionit edhe në territorin shqiptar çoi në zbulimin edhe të 4 tonëve të tjera drogë të magazinuar dhe të gatshme për transport detar në zonë e Babicës së Vogël në rrethin e Vlorës. Por, ky aksion diskret solli edhe përplasjen ndërmjet policisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ku deri në momentin e kryerjes së operacionit, uniformat blu u mbajtën larg nga frika e dekonspirimit. Gjithashtu, "ABC News" ka mësuar në dosjen e cila mbahet sekret nga organi qendror i akuzës se gjatë vitit 2014-2015, grupi kriminal i Habilajve ka dërguar në Itali ngarkesa me drogë edhe në rrugë ajrore, konkretisht në zonë e Akrenisë, po në Vlorë. Për



Moisi Habilaj

KËRKESA

Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkon prangosjen e deputetit Saimir Tahiri, pasi emri i ish-ministrit të Brendshëm ka dalë gjatë bisedave me anëtarët grupit, ndërsa dyshohet se i ka ndihmuar këta të fundit të jenë të paprekshëm në qarkun e Vlorës. Aktualisht fati i deputetit Tahiri mbetet në dorën e ligjvënësve nëse do t'ia heqin apo jo mandatin.

Kreu i Antimafies italiane: Po na pushton droga nga Shqipëria, ta legalizojmë

ITALI - Tonelatat e drogës që transportohen nga Shqipëria në Itali kanë alarmuar prokurorin e përgjithshëm të Antimafies italiane, Franko Roberti. Ky i fundit ka propozuar legalizimin e drogave të lehta, si një mënyrë kjo për të luftuar bandat kriminale. Prokurori i ka bërë thirrje parlamentit dhe qeverisë italiane që të gjejnë një zgjidhje për këtë shqetësim. "I kemi kërkuar parlamentit dhe qeverisë italiane që të gjendjet një zgjidhje. Ose të bashkojmë të gjitha forcat për të luftuar trafikun e drogave të lehta, ose t'i japim shtetit monopolin e prodhimit dhe shitjes së tyre, duke njohur mungesën e vlerës morale të përdoruesit të saj. Objektivi i shtetit është



Prokurori i Përgjithshëm i Antimafies italiane, Franko Roberti

të të luftojë fuqitë kriminale dhe jo të bashkëtojë me ta", pohoi prokurori. Roberti shpjegoi se: "Drogat e lehta kanë pushtuar vendin duke shkakuar viktima siç ndodhi në San Marco in Lamis, në provincën e Foxhias që vjen nga trafiku i drogave të lehta nga Shqipëria". Sipas

këtë aktiviteti kriminal, homologët e Katania kanë kryer përgjime edhe në territorin shqiptar. Ndërkaq, Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkon prangosjen e deputetit Saimir Tahiri. Kjo për faktin se emri i ish-min-

istrit të Brendshëm ka dalë gjatë bisedave me anëtarët grupit, si edhe i ka ndihmuar këta të fundit të jenë të paprekshëm në qarkun e Vlorës. Aktualisht fati i deputetit Tahiri mbetet në dorën e ligjvënësve, nëse do

t'ia heqin apo jo mandatin e deputetit. Prokuroria kërkon burgosjen e Tahirit, pasi ai akuzohet për "trafik të narkotikëve e kryer në grupin e strukturuar kriminal" dhe "korrupsionit pasiv i zyrtarëve të lartë".



Personat e arrestuar në Itali

Prokuroria: Mikeshë e Habilajt

Dëshmia e oficerës së policisë "rezikon" ish-ministrin Tahiri

TIRANE - Dëshmia e një oficerëje policie të Vlorës është kthyer në provën e fortë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda për të kërkuar heqjen e imunitetit të ish-ministrit Saimir Tahiri dhe arrestimin e tij për akuzën e "Trafikut të drogës" dhe "Korrupsionit pasiv". Dy ditë më parë, në seancën me dyer të mbyllura të Këshillit të Mandateve, prokurorët deklaruan se disponojnë dëshminë e një oficerëje policie, e cila ka pranuar të bashkëpunojë. Kjo e fundit thuhet se ka pasur njohje me Moisi Habilajn, trafikantin që përmend në bisedat e tij ish-ministrin. Mësohet se ajo ka folur dhe ka dhënë dëshminë e saj para prokurorisë kundër Saimir Tahirit. Frika më e madhe e prokurorisë në rast se ish-ministri i Brendshëm nuk arrestohet me autorizimin e Kuvendit është pikërisht intimitimi i saj. Gjatë hetimeve të kryera, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka mësuar në përgjimet e bisedave të anëtarëve të grupit se kjo oficerë ka qenë mike e kreut të grupit kriminal, Moisi Habilaj, i arrestuar pak ditë më parë nga prokuroria e Katania. Nisur nga këto të dhëna, prokuroria ka shoqëruar pak ditë më parë këtë punonjëse police, duke i administruar dëshminë e saj në dosje. Mësohet se oficerja ka treguar miqësinë që ka pasur me Moisi Habilajn, duke shtuar se ky i fundit i ka thënë se është kushëri i Saimir Tahirit, ish-ministrit të Brendshëm. Ajo ka dëshmuar se kjo bisedë është bërë në një bar-kafe në qytetin e Vlorës. Sipas kësaj oficerëje, Moisi Habilaj i ka pohuar se kishte siguri në këtë punë, pasi ishte kushëri i Tahirit. Madje, ajo pretendon se Habilaj i ka premtuar se do ndërhynte lart për ta ngritur në gradë dhe për ta emëruar në një pozicion më të mirë punë në polici. Oficerja, e cila ishte kthyer në informatore të Habilajve, ka pranuar të bashkëpunojë me prokurorinë, por nisur nga situata ka kërkuar garantimin e mbrojtjes fizike dhe jetës së familjarëve të saj. Shkak për këtë lëvizje të saj duket se ka qenë frika e arrestimit nga policia, duke pranuar të rrëfjë gjithçka di rreth lëvizjeve të grupit që drejtohej nga Habilaj.





Prokuroria zbardh dosjen e grupit kriminal, të përfshirë edhe zyrtarë policie

Trafiku i drogës, gjykata lë në burg dy miqtë e Habilaive

Seiti, në kërkim ndërkombëtar nga Italia

Ina Allkanjari

Gjykata e Krimeve të Rënda ka lënë dje në burg anëtarët e grupit kriminal "Habilaj". Bëhet fjalë për Nezar Seitin dhe Armando Koçerrin, të cilët u arrestuan pak ditë më parë në fshatin Babicë të Vlorës. Relatorja Liljana Baku dha masën e sigurisë "arrest me burg" pa afat për të pandehurin Koçerri, i cili është pronari i banesës në fshatin Babicë, ku u gjetën dhe u sekuestruan rreth 4 tonë kanabis. Ndërkohë, i pandehuri Nezar Seiti është lënë në burg 20 ditë, duke i dhënë kohë prokurorisë të paraqesë në një seancë të ardhshme përkthimet e plota zyrtare të materialeve të mbërritura nga Italia në ngarkim të tij. Nga ana tjetër, Gjykata e Katanias ka kërkuar masën e arrestit për Seitin, pasi dyshohet si ndërmjetës dhe financues i vëllëzërve Habilaj, duke transportuar drogë nga Shqipëria në Itali. Prokuroria për Krime të Rënda ka zbardhur dosjen e grupit kriminal "Habilaj", ndërsa bën me dije se në aktivitetin e paligjshëm dyshohet se janë përfshirë edhe disa zyrtarë policie.



Nezar Seiti dhe Armando Koçerri, dje në gjykatë

në vitin 2013, goditën anëtarët të këtij grupi në Itali. Në bazë të të dhënave të bëra publike për këtë operacion në Itali, Prokuroria për Krime regjistroi një tjetër procedim penal. Pasi u konstatua se bëhej fjalë për të njëjtët persona, për të cilët Prokuroria për Krime të Rënda kishte regjistruar procedim penal në vitin 2016, atëherë u vendos bashkimi i procedimeve penale. Nga ana e autoriteteve italiane të drejtësisë është arrestuar personi në hetim, Moisi Habilaj dhe disa persona të tjerë, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të trafikimit të narkotikëve, kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal. Arrestimi i këtij shtetasi është bërë në funksion të hetimeve, që autoritetet italiane po zhvillojnë në lidhje me faktin e sekuestrimit të sasisë prej 3.5 tonë lëndë narkotike të llojit kanabis sativa. Nga hetimet rezultoi se shtetasi Moisi Habilaj në bashkëpunim me shtetasin Nezar Seiti dhe disa persona të tjerë kanë arritur të bëjnë në mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike dhe trafikimin e saj në mënyrë të organizuar nga Shqipëria në Itali, duke vepruar në formën e grupit të strukturuar kriminal.

GJYKATA E KATANIAS

Gjykata e Katanias ka kërkuar masën e arrestit për Seitin, pasi dyshohet si ndërmjetës dhe financues i vëllëzërve Habilaj, duke transportuar drogë nga Shqipëria në Itali. Prokuroria për Krime të Rënda ka zbardhur dosjen e grupit kriminal "Habilaj", ndërsa bën me dije se në aktivitetin e paligjshëm dyshohet se janë përfshirë edhe disa zyrtarë policie.

KRONOLOGJIA E DOSJES "HABILAJ"

- Mëngjesin e 17 tetorit, policia italiane ka shkatërruar një organizatë kriminale të përbërë nga shqiptarë dhe italianë, ku ranë në pranga 7 persona. Në mesin e të pranjosurve janë edhe 3 shqiptarë, Moisi Habilaj 39 vjeç, Maridian Sulaj 29 vjeç dhe Fatmir Minaj 55 vjeç. Ata akuzohen se kanë trafikuar 3.5 tonë kanabis sativa si dhe kanë kryer edhe trafik armësh.
- Të hetuarit e grupit të strukturuar kriminal për trafikimin e lëndëve narkotike janë Moisi Habilaj, Maridian Sulaj, Fatmir Minaj, Nezar Seiti, Armando Sulaj, Trigenis Mezura, Sabaudin Çelaj, Florian Habilaj si dhe shtetasit italianë të arrestuar Antonio Riela, Vincenzo Spampinato, Angelo Busaca, Gianluca Passavanti. Hetimi ka nisur nga Gjykata e Katanias në tetor të vitit 2013.
- Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar nga Komisioni i Mandateve në Kuvendin e Shqipërisë dhënien e autorizimit për "arrestimin, heqjen e lirisë dhe kontrollin personal të banesës" për deputetin Saimir Tahiri. "Subjekti nën hetim, Saimir Tahiri, më datë 05.11.2013 ka realizuar shitjen e automjetit me targa AA0003GB, tek personi nën hetim, Artan Habilaj, vëllai i të arrestuarit Moisi Habilaj. Më datë 16.08.2014, 30.08.2014, 29.08.2014, 08.08.2014 personi nën hetim, Saimir Tahiri udhëton dhe përdor mjetin me targa AA0003GB, i cili sipas aktit të shitjes, rezultoi të jetë shitur më datë 05.11.2013. Në këto udhëtime rezultoi që personi në hetim, Saimir Tahiri, ka qenë i shoqëruar nga subjektet e tjera të dyshuara Artan Habilaj etj.", thyhet në dosje.
- Policia dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda janë duke vijuar operacionin në disa fshatra të Vlorës për të bërë të mundur gjetjen dhe arrestimin e personave të shpallur në kërkim, të cilët janë të përfshirë në trafikun e drogës, të njohur si pjesëtarë të grupit të Habilajve. Kërkimet janë përqendruar kryesisht për vënien në pranga të shtetasit Florian Habilaj, por edhe për persona të tjerë, për të cilët tashmë ka një urdhër arresti nga prokuroria italiane.

PËRFSHIRJA E ZYRTARËVE TË POLICISË

Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedim penal ndaj grupit të njohur si "Habilaj" në vitin 2016, në bazë të informacioneve të siguruar nga shërbimet inteligjente. Në këtë informacion flitej edhe për përfshirje të zyrtarëve të policisë. Pas verifikimeve të nevojshme të këtij materiali, prokuroria ka zhvilluar hetimet, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se përfshirja e dyshuar e zyrtarëve të policisë në bashkëpunim me trafikantët mund të cenonte procesin hetimor.



pranë kësaj prokurorie. Por, deri në momentin e ndalimit nuk ishin siguruar prova të plota në ngarkim të tij nga hetimet e kryera në territorin shqiptar. Ndërkohë, prova të siguroshesha prova të plota ligjore mbi aktivitetin kriminal të anëtarëve të këtij grupi. Ndërkohë, autoritetet italiane, në vijim të një hetimi të nisur prej tyre

parë në Itali një operacion kundër disa anëtarëve të tjerë të këtij grupi kriminal. Në vijim të komunikimit me autoritetet italiane, Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedim penal ndaj grupit të njohur si "Habilaj" në vitin 2016, në bazë të informacioneve të siguruar nga shërbimet inteligjente. Në këtë informacion flitej edhe për përfshirje të zyrtarëve të policisë. Pas verifikimeve të nevojshme të këtij materiali, prokuroria ka zhvilluar hetimet, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se përfshirja e dyshuar e zyrtarëve të policisë në bashkëpunim me trafikantët mund të cenonte procesin hetimor.

Në bazë të akteve hetimore të deritanishme, rezultoi se Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedim penal ndaj grupit të njohur si "Habilaj" në vitin 2016, në bazë të informacioneve të siguruar nga shërbimet inteligjente. Në këtë informacion flitej edhe për përfshirje të zyrtarëve të policisë. Pas verifikimeve të nevojshme të këtij materiali, prokuroria ka zhvilluar hetimet, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se përfshirja e dyshuar e zyrtarëve të policisë në bashkëpunim me trafikantët mund të cenonte procesin hetimor. Në prill të 2017-ës, pra rreth një vit pasi Prokuroria për Krime të Rënda kishte regjistruar procedim penal ndaj këtij grupi, nga ana e Policisë së Vlorës është përcjellë një material referues, i cili kishte nevojë për shumë veprime të tjera hetimore shtesë për të siguruar provat e nevojshme ligjore. Deri në tetor të 2017-ës nuk u arritën të siguroshesha prova të plota ligjore mbi aktivitetin kriminal të anëtarëve të këtij grupi. Ndërkohë, autoritetet italiane, në vijim të një hetimi të nisur prej tyre

Më datë 18.10.2017, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Armand Koçerri në fshatin Babicë e Vogël, tek një dhomë të katit të parë është gjetur dhe sekuestruar arsasia e lëndës narkotike e llojit kanabis sativa, prej 3978 kg, e paketuar në disa pako të mbështjella me qese natribani. Në kuadër të këtij operacioni në Vlorë është gjetur dhe sekuestruar mjeti lundrues gomone, që dyshohet se është përdorur nga grupi kriminal për trafikimin e lëndës narkotike. Në këto rrethana, nga policia gjyqësore, më datë 18.10.2017 është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Armand Koçerri, për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal. Po ashtu, me urdhër të prokurorisë është kryer ndalimi i shtetasit Nezar Seiti, pasi dyshohet si anëtar i grupit kriminal.

ÇESHTJA "TAHIRI" AKUZAT

Mbrojtja për Tahirin, kreu i PD: Kryeministri po sakrifikon integritetin

Valentina Madani

Opozita është gati të mbushë sheshet e Shqipërisë në rast se mazhoranca qeverisëse ditën e mërkurë do të shpëtojë nga prangat ish-ministritin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Të mërkurën parlamentin do të shqyrtojë dy raportet e Këshillit të Mandateve në lidhje me kërkesën e prokurorisë për të autorizuar arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Mazhoranca ka autorizuar hetimin dhe kontrollin e banesës, por jo arrestimin. Ndërsa, opozita kërkon arrestimin e tij sipas kërkesës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Parlamenti do të duhet të shprehë me shumicë votash se cilin nga raportet do të mbështesë. Nisur nga ky vendim, burime brenda PD-së konfirmojnë se opozita do të nisë protestat pas së mërkurës, nëse lihet i pandëshkuar Saimir Tahiri. Fillimin e protestave e paralajmëroi edhe nënkryetari i PD-së, Edi Paloka sipas të cilit, "rilindasit" kanë marrë urdhër të mbrojnë jo Tahirin, por Ramën. Ky është akti i fundit. Po u lejua, do të jetë edhe akti i fundit i drejtësisë dhe demokracisë në Shqipëri. Kjo nuk do të lejohet. Rama të bëhet gati për përballje. Përballja do të jetë pa asnjë kompromis dhe do të ketë vetëm një fund, atë të Ramës dhe klikës kriminale".

AKUZAT

Kreu i opozitës, Luzlim Basha, e akuzon kryeministrin Rama se në takimin me kërret e policisë i dha garanci publike krimi, duke sakrifikuar integritetin e shqiptarëve. Sipas Bashës, qëllimi i daljes së Ramës para drejtuesve më të lartë të policisë kishte për qëllim t'u jepte garanci publike kriminelëve se pavarësisht ngjarjeve të fundit, ai e ka në kontroll policinë, se Saimir Tahiri është i sigurt dhe interesat e kriminit janë të mbrojtura. "De fakto - tha ai - qeveria ka rënë". Sipas Bashës, gjendja e vërtetë e policisë së Ramës lexohet në përgjimet e Antimafias italiane. Basha akuzoi se Edi Rama ka rrëzuar policinë e vendit dhe po sakrifikon integritetin evropian të Shqipërisë. "Qëllimi i daljes së Edi Ramës para drejtuesve më të lartë të policisë ishte t'u jepte garanci publike kriminelëve se pavarësisht ngjarjeve të fundit, ai e ka në kontroll policinë, se Saimir Tahiri është i sigurt, se interesat e kriminit janë të mbrojtura e nuk do të preken. Edi Rama bëri të qartë pa asnjë fije dyshimi se ai ka zgjedhur të sakrifikoje qeverisjen e vendit, integritetin evropian, të ardh-

Opozita gati për protesta, Basha: Rama u dha garanci kriminelëve

"A do ketë çmim për vëllain e Xhafajt?"



Kreu i PD-së, Luzlim Basha

AKUZA

"Gjendja e vërtetë e policisë së Ramës lexohet në përgjimet e Antimafias italiane. Atje do të gjeni të vërtetën e pacensuruar dhe të patransformuar nga propaganda e Edi Ramës, e cila financohet nga paratë e drogës", tha z. Basha.



Kryeministri Edi Rama, dje me drejtuesit e Policisë së Shtetit

"Pistat ushtarake u dhanë për avionët e drogës"

Alibeaj: Rama i dha kohë Tahirit të zhdukë provat

Deputeti demokrat, En Dheke Alibeaj, anëtar i Këshillit të Mandateve dhe Rregullorës akuzoi dje mazhorancën dhe kryeministrin Rama se me mbrojtjen ndaj Saimir Tahirit i dha mundësinë që të zhdukë çdo provë që e implikon atë në trafikun e drogës. Ai tha se provat e prokurorisë ishin bindëse, por se PS e mbrojti me urdhër të Ramës, pasi në rënien e tij do merrte edhe kryeministrin. Sipas Alibeajt, provat e paraqitura nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për arrestimin e Tahirit janë jo vetëm bindëse, por tronditëse. "PS në Komisionin e Mandateve me urdhër të Edi Ramës nuk e la drejtësinë të funksionojë. I dha kohë Tahirit të zhdukë çdo provë, në shpirt dhe ministri. Pakti është që Tahiri t'ia hedhë pa u



lagur që të shpëtojë Rama dhe të tijtë. Tahiri në rënien e tij do të merrte me vete edhe Ramën, për shkak të dëshmiave dhe fakteve të rënda që ka për të. Edhe pse drejtësia italiane solli mijëra faqe, ai u mor sërish në mbrojtje nga Edi Rama. Historia është e thjeshtë, parlamenti gjykon vetëm legjitimitetin dhe ligshmërinë e kërkesës, nuk pranon dhe gjykon prova, sepse

PROVAT

Shtyrjen e heqjes së imunitetit ndaj ish-ministrit Tahiri, Alibeaj e quajti si mundësi që i dha Rama atij për të zhdukur provat, ndërsa bëri thirrje: "Shqiptarët nuk kanë çfarë të presin më për të marrë në dorë fatet e tyre".

nuk është gjykatës. Në asnjë ligj nuk është thënë që duhet të paraqiten prova. Parlamenti gjykon politikisht dhe jo si gjykatë. E vërteta e Saimir Tahirit është se në dijeninë e plotë të tij me bekimin e Edi Ramës ishte kapiteni i narkoshtetit. Ai u bë ministër i Brendshëm nga Rama si garanci për kriminelët", deklaroi deputeti i PD-së.

men e vendit, për të mbrojtur krimin", deklaroi z. Basha. Ai akuzoi më tej: "Në krah të Fatmir Xhafajt sot (dje) Edi Rama u betua se do vendosë shpërblime për kokën e kriminelëve në kërkim. Sa do t'ia vërë çmimin kokës së vëllait të ministrit të Brendshëm, që kërkohej nga policitë e gjysmës së botës për trafik kokaine? Rama dhe ministrat e tij janë të zhytur në krim dhe të kapur nga krimi. Qeverisja e tij de fakto ka marrë fund". Kreu i PD-së përmendi se: "Nuk ka tregues më të

dhimbshëm se sa poshtë ka rënë policia e një vendi, se sa të shohësh drejtuesit më të lartë të policisë, të detyruar të dëgjojnë e mbajnë shënim me kokën ulur si memecë, çoroditjet e një njeriu që ka humbur çdo sens të realitetit dhe çdo kontroll të vetes".

Denoncimi



SALI BERISHA

Ish-kryeministri Berisha, deklaroi se kryeministri Rama se bandat e krimi do të shkojnë në ferr e krahaso me mallkimin e plakave. "Rama kërcënon bandat me mallkimin plakash: "Në ferr shkofshin të gjithë! Kësaj i thonë luftë kundër krimi të organizuar?", shkruan Berisha. Po dje, Berisha publikoi një SMS të një qytetari dixhital, ku shihet një avion që kalon në Elbasan, ndërsa shprehet: "Mizat po fluturojnë në narko-shtetin e Noriegës!"

Deputeti i PD: Rrëzoni qeverinë!

Bylykbashi: Tahiri mori miliona euro dhe dhurata nga trafikantët

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, u bëri dje thirrje shqiptarëve që të rrëzojnë qeverinë, pasi sipas tij, ligji është në duart e Edi Ramës dhe është i pabarabartë. Duke u ndalur të kërkesa e Prokurorisë për arrestimin e Tahirit, deputeti shkruan në "Facebook" se mazhoranca socialiste po përdor imunitetin parlamentar për ta mbrojtur deputetin nga burgu. Sipas tij, për Ramën dhe ministrat e tij, bashkëpunëtorë në krim, ligji është më i barabartë se për të tjerët, teksa sjell në vëmendje rastin e komisar Zaganit, i cili u arrestua pasi denoncoi trafikun e drogës të Habilajve. "Ligji është i barabartë për të gjithë. Por, për Ramën dhe ministrat e tij bashkëpunëtorë në krim është edhe më i barabartë se për të tjerët. Komisar Zagani denoncoi me fakte trafikun e drogës së Habilajve edhe me makinën e Saimir Tahirit, përfshirjen e ministrit dhe zyrtarëve të policisë. Saimir Tahiri dhe Edi Rama e denigrojnë. Çfare ndodhi? Zagani u arrestua për shpërdorim detyre, sepse ua kishte dhënë informacionin agjencive ligjzbatuese të Italisë dhe u detyrua të kërkojë azil politik. Saimir Tahiri, ministër i Brendshëm, rezultoi në përgjimet e italianëve si i lidhur me trafikun e Habilajve dhe se ka marrë miliona euro dhe dhurata nga trafikantët. Prokuroria kërkon arrestim, me qëllim që të mos prishë provat. Saimir Tahiri kërcënoi kryeministrin. Çfarë ndodhi: mazhoranca socialiste vendosi që të përdorë imunitetin parlamentar për të mbrojtur Saimir Tahirin nga arrestimi e ta mbajë të lirë. Shqiptarë, ligji në duart e Edi Ramës është i pabarabartë. Kjo qeveri duhet rrezuar!", shkruan Bylykbashi.

Thirrja.

"Shqiptarë, ligji në duart e Edi Ramës është i pabarabartë. Kjo qeveri duhet rrezuar!", shprehet Bylykbashi.



Ministri, mesazh për policët e korruptuar dhe të inkrimnuar

Xhafaj: Besimi është lëkundur, nëse abuzoni, më mirë ikni vet

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj me tone të forta iu drejtua dhe me mesazh të qartë efektivëve dhe drejtuesve të Policisë së Shtetit të bëjnë me përgjegjësinë e duhur detyrën e tyre, në të kundërt është më mirë të largohen vetë. Në një takim me Policinë e Shtetit, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dha një mesazh për punonjësit e policisë të korruptuar apo të përfshirë në aktivitete kriminale. Duke marrë shkas nga ngjarjet e fundit në lidhje me trafikun e drogës të bandës së Habibajve, Xhafaj u bëri thirrje policëve të korruptuar që të largohen vetë nga Policia e Shtetit, si dhe i mësoi sërish vetingut në polici. "Dëmi që i shkaktojme policisë punonjësit të paafat apo të ko-



PARALAJMËRIMI

"Jam i ndërgjegjshëm për rëndësinë themelore që ka sot rendi dhe siguria dhe sa e rëndësishme është përgjegjësia që kam për realizimin e detyrës. Nëse nuk mund të përmbushni këtë përgjegjësi dhe nuk i bëni detyrat, nëse nuk jeni të ndërgjegjshëm për punën që bëni, më mirë largohuni", tha z.Xhafaj.

rruptuar është shumë i lartë. Ndaj, unë i kam mëshuar vetingut në polici. Ky proces synon të pastrojë sa më shumë policinë nga

njerëzit e korruptuar dhe të largojë të paafat nga kjo organizatë. Procesi i vetingut synon të promovojë dhe nxjerrë në dritë të

gjithe ata të ndershëm që shërbejnë sot në strukturat e Policisë së Shtetit. Ne do të punojmë fort që të rikthejmë besimin te Policia e Shtetit, besim i cili është lëkundur përmes ngjarjeve të muajve të fundit. Ambicia ime është një Shqipëri pa kanabis, një Shqipëri ku krimi ndihet i kërcënuar, ta ndalojmë përfshirjen e të rinjve në rrugën e krimi", deklaroi Xhafaj. Ministri i Brendshëm përsëriti faktin se në muajin nëntor në Shqipëri do të vijnë agentë të FBI-së nga Amerikane për të bashkëpunuar me policinë shqiptare. Këta agentë do të vendosen në zyrat e Ministrisë së Brendshme.

Kryeministri: Do shkrij të gjithë zinxhirin e policisë aty ku zbulohet kanabis

Agjentët e FBI në Tiranë, Rama: Kontroll policëve për sinqeritetin

"Shpërblim kush denoncon të kërkuarit e drejtësisë"

Kryeministri Edi Rama përballë drejtuesve të Policisë së Shtetit e cilësoi dje debatin e fundit të krijuar për shkak të akuzave ndaj ish-ministrit Tahiri, si furi balte që synon të demotivojë punën e Policisë së Shtetit. "Situata me kanabisin - tha Rama - kërkon një operacion të pamëshirshëm brenda forcave të policisë. Kryeministri i konsideroi akuzat e kazanit politik-mediatik sulmet ndaj policisë, ndërsa pranoi se situata nga kanabisi ishte më e rënda vitin e kaluar. Rama tha se është dyfishuar numri i grupeve kriminale të shkatërruara krahasuar me vitin 2013, ndërsa paralajmëroi se të gjithë punonjësit e policisë që kanë pasuri të pajustificuara nga paga e tyre nuk do të shpëtojnë. Rama u ndal gjithashtu tek ngjarja e Elbasanit, ku elementë kriminalë goditën makinën e zvdrejtorit të policisë, duke akuzuar për këtë prokurorin, pasi siç theksoi ai, "nëse do të kishte prokurorë, nuk do të kishte ndodhur ajo ngjarje". Kryeministri tha se qeveria do të merrte një vendim që të paguhej çdokush që jepte informacion për kapjen e personave të kërkuar në të gjithë territorin e vendit. "Do të vijë një agjent prestigjioz i FBI. Mbërrin edhe një agjent tjetër për të mbështetur policinë kundër krimi të organizuar. Po diskutojmë me një kompani hetimesh, që drejtohet nga ish-agjentë të FBI-së dhe do të vijnë këtu. Do sjellin eksperiencë që ne nuk e kemi, fuqi motivuese, por do sjellin edhe instrumentet e tyre operacionale për vetingut në Policinë e Shtetit. Nuk do ketë drejtues policie që nuk do të kalojë testin. Ka



Foto ilustruese

"TAHIRI"

"Kommunikimi javor do të bëhet në këtë faqe nesër (sot) në mëngjes, ora 8.30, përpara grupit parlamentar socialist, mbi kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda lidhur me deputetin Saimir Tahiri", shkruan

shikojnë dhe do thonë mbaroi ndeshja, fitoi 'Skënderbeu' dhe humbi 'Skënderbeu'? Jo, kanë format e tyre. Ama një gjë është e sigurt, që mbi bazën e kësaj lufte, faza e dytë, të cilën e kemi lajmëruar që në korrik për t'u shkuar tani pas jo më rrënjeve dhe parcelave, por pasurive të tyre. Kjo është operacionale. Do të vazhdojë kundër elementëve kriminalë dhe kundër elementëve të inkrimnuar në polici. Nuk do shpëtoj asnjë punonjësit policie që gjithë jetën ka punuar në polici dhe ka pasuri të pajustificueshme. Vetingut në Policinë e Shtetit është për të ndarë qartë dhe prerë të njomët nga të thatët, shapin nga sheqeri", - tha ai. Vetingut në radhët e policisë, me ndihmën e ekspertëve të FBI-së dhe atyre gjermanë do të rikthejë besimin e cenuar të Policisë së Shtetit. "Nuk kishte gjë më degraduese nga pikëpamja e perceptimit për Policinë e Shtetit, sesa ajo video që doli dhe u pa nga Elbasani. Nuk do të punojë asnjë punonjësit policie që ka punuar të gjithë jetën në polici e që ka pasuri të pajustificueshme. S'ka si shpëton. Vetingut në Policinë e Shtetit është për të ndarë të njomët nga të thatët", tha z.Rama.

VETINGU

"S' do të punojë asnjë punonjësit policie që ka punuar të gjithë jetën në polici e që ka pasuri të pajustificueshme. S'ka si shpëton. Vetingut në polici është për të ndarë të njomët nga të thatët", tha Rama.

AGJENTËT

"Do të vijë një agjent prestigjioz i FBI. Nuk do ketë drejtues policie që nuk do të kalojë testin. Ka edhe një instrument për sinqeritetin, poligraf. Të gjitha këto do të jenë këtu", tha kryeministri.

SHPËRBLIMI

"Do t'i propozoj qeverisë që të vendosë çmim për kokën e çdo të kërkuarit në Shqipëri. Kush e denoncon dhe mundëson duke e denoncuar kapjen e tij do paguhet", tha z.Rama.

dhe një instrument për sinqeritetin, poligraf. Të gjitha këto do të jenë këtu", tha kryeministri Edi Rama para drejtuesve të policisë. Duke numëruar sukseset e Policisë së Shtetit dhe duke e quajtur sulmin ndaj policisë baltoje nga kazani për demotivimin e saj, Rama bëri një paralajmërim të fortë. "Nëse

sot policia zbulon parcelë kanabisi në Rinas, i gjithë zinxhiri aty duhet të shkakohet në çast. Është e pamundur të justifikohet një prani e tillë në një fazë finale operacioni, kur një muaj kanë zgjatur fluturimet, sepse partnerët tanë nuk arrijnë të bindeshin për luftën ndaj kanabisit. Ishte një teori

që do ta shtyjmë edhe në tetor, sepse është një lloj bime tjetër që mund të mbijë", - tha ai. Sipas Ramës, kjo është një ndeshje që nuk fitohet në tavolinë, fitohet atje. "Je ti, por është edhe kundërshtari. Në rastin konkret disavantazhi krijohet nga blerja e lojtarëve të tjetrit. Kjo është e qartë. Plani kombëtar ish-

te sintezë e një eksperiencë dhe qartësi për të dhënë goditjen finale. Ka ndonjë njeri të arsyeshem që nuk e mendon: çdo me thënë goditje finale? Do me thënë qindra milionë euro. Këtë do me thënë. Mbyllja me forcë e një tregu shumë tërheqës. Në këtë treg, këto forcat që po lënë tregun do rrinë do

PARLAMENTI IMUNITETI

Kryetari i grupit te LSI: Të mërkurën në kuvend të zgjedhë krimin apo drejtësinë

Vasili, Ramës: Kujdes me joshjet e telefonatat që u bën personave kyç

"Takimi, vrasësi u kthye në vendin e krimit"

Valentina Madani

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili i shpalli dje sfidë të hapur kryeministrit Edi Rama për të zgjedhur ditën e mërkurë nëse do të jetë me krimin, apo me drejtësinë. Në një deklaratë për mediat, Vasili i referohet seancës parlamentare të së mërkurës, kur Parlamenti do të votojë për heqjen ose jo të imunitetit të Saimir Tahirit, për të cilin kërkohet arrestimi nga prokuroria. Vasili i kërkoi kryeministrit Rama që të tregohet i kujdesshëm. Duke iu referuar seancës së të mërkurës ku do të vendoset 'fati' i Saimir Tahirit, Vasili theksoi se ajo është dita e provës së madhe të Ramës. "E vërteta e luftës me krimin dhe kjo betejë morale dhe politike është të mërkurën. Të mërkurën ky kryeministër ka një provë, të vendoset me krimin apo kundër tij", - tha Vasili duke iu drejtuar edhe me një thirrje: "Bëj kujdes edhe me joshjen apo presionin që u bën personave kyç në çështje".



Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili

SFIDA

"Megjithatë ka një provë, është prova e së mërkurës. Prova është në Kuvend, ose mbështesim prokurorinë me të gjithë kërkim për të gjetur fajtorët dhe do të zbardhur këtë veprimtari të këtij grupi shumë të strukturuar të rrezikshëm kriminal. Në rast se nuk e bën këtë, nuk ka pse kthehet përsëri si vrasësi në vendin e krimit. Është më mirë të struket diku deri sa ta gjejmë", tha Vasili.



Pakti, Noka: Rama u sigurua që Tahiri s'do e marrë me vete

Deputeti i PD-së, Flamur Noka, deklaroi dje se kryeministri Rama po mbrosh ministritin Tahiri pa garancisë që mori nga ky i fundit me kushtin se nuk do e fundoste edhe atë. Noka shkruan në 'FB' se Rama u fsheh 4 ditë në errësirë dhe nënshkroi paktin, ku ish-ministri nën akuzë ndërkombëtare për trafik droge nuk do e marrë me vete në pusin e thellë të drogës e parave të pista. "4 ditë u fsheh, nuk e pa njeri ku e kishte futur kokën, jepte e merrte me Tahirin, i çonte emisarë e ndërmyjetës dhe pasi nënshkroi paktin me të, paktin ku ish-ministri nën akuzë ndërkombëtare për trafik droge nuk do e marrë me vete në pusin e thellë të drogës e parave të pista ku janë zhytur bashkë, e bashkë me të edhe shumë ministra e familjarë të tij, vetëm pasi u sigurua që Tahiri s'do flasë dhe pasi Tahiri mori mbrojtje prej tij duke mos lejuar prokurorinë të bëjë punën e saj, Edi Rama u shfaq në publik. Ishte ai që u zhduk në këto 4 ditë e fundit, ku të palartat dolën në shesh. Nuk ia pa askush fytyrën. Mori garanci nga Tahiri që s'do flasë për përfshirjen e tij direkte, që s'do përdorë prova filmime e fakte që ai i ka për të, për ministrin e për Olsa dhe pas kësaj, u shfaq me predikimin e zakonshtëm dhe sulmin ndaj opozitës. Tashmë nuk ka zgjidhje tjetër vec rrezimit të tij", tha z.Noka.

narkoshtet, që drejtohet nga një narkotrafikant", u shpreh z.Vasili. Sipas tij: "Vrasësi u kthye në vendin e krimit, pasi i zhveshi nga

çdo përgjegjësi, sepse e drejton ai Policinë e Shtetit dhe jo ligji, pasi e mbolli vendin me drogë, i hapi hapësirat kriminit deri në karrigen e

qeverisë, zgjodhi të vinte në veprim edhe krimin e 25 qershorit. Pra, i bëri dëmin më të madh policisë, dorëzim para krimeve dhe trafikëve,


mbështetës pasiv të tyre e të dorëzuar para krimit, pasi kemi të bëjmë me një narkoshtet që drejtohet nga një narkotrafikant".



LSI: Mazhoranca mbrojtë Tahirin

Rama: Kuvendi, përballë provës në anën e ligjit, apo krimit

Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama, me një postim në faqen e tij në 'FB' shkruan se Kuvendi tani është përballë provës së në anën e kujt duhet të jetë. Zvendëskryetari i LSI-së thekson se shteti ndodhet përballë grupit të strukturuar kriminal, ndërsa Kuvendi përballë provës së ai takon imunitetit të deputetit. Mes të tjerash, ai shtron një pyetje për qeverinë "Rama": "Për reformën në drejtësi, apo për pandëshkueshmërinë?". "Shteti përballë grupit të strukturuar kriminal. Ligji përballë krimit të organizuar! Kuvendi përballë provës: në anën e ligjit, apo me krimin e organizuar? Në mbrojtje të shtetit, apo në shërbim të grupit të strukturuar kriminal? Për reformën në drejtësi, apo për pandëshkueshmërinë?", shkruan zyrtari i lartë i LSI-së në "Facebook".



Ambasadori Donald Lu, dje në Korçë

Donald Lu, në aktivitetin "Dita e Amerikës" në Korçë

Donald Lu njihet tashmë si ambasadori që i thotë troç, hapur e shqip kritikant, e ndërsa përmend edhe emra kur bëhet fjalë për kriminelë. Por, teksa këto ditë tensionet politike janë të larta për shkak të akuzave që ka ngritur Prokuroria për Krimet e Rënda ndaj deputetit Saimir Tahiri dhe po kërkon nga Kuvendi autorizimin për heqjen e imunitetit dhe arrestimin e tij, ambasadori Donald Lu nuk është parë të dalë në asnjë aktivitet publik e as të përfshihet në këtë çështje. Lu në kuadër të "Ditës Amerikane" ishte në Korçë, ku është takuar me kryebashkiakun Sotiraj Filo dhe ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi. Në një postim në "Facebook", ministri Peleshi shprehet: "Dita e Amerikës - një event fantastik në kujtim të shumë emigrantëve korçarë, të vjetër dhe të rinj, që i dhanë Korçës një lidhje të fortë shpirtërore me Amerikën". Më tej, Peleshi shprehet: "Ekspozimi i letrave dhe fotografive të kurbetllive, gatimet dhe muzika amerikane, historitë e ndara me vizitorët e shumtë nga e gjithë Shqipëria dhe sharmi i Pazarit të Vjetër e bënë këtë fundjavë në Korçë një mrekulli. Prania e ambasadorit Lu i shtoi vlerat kësaj fundjave të veçantë". Po ashtu, ministri Peleshi përgëzon Bashkinë e Korçës për organizimin e eventeve të tilla në Korçë. "Përgëzime bashkisë dhe organizatës Njerëz dhe Ide. Një model për t'u ndjekur", shkruan Peleshi.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandën për shpënj e pasurisë së paluajshme "1% pjesë ideale takuese e detyrës Hyson-Mehmeti Kasso, tek pasuria se paluajshme e ligji apartament, me numër pasurie 489-1-3, Vullmi 11, Faqe 23 në Zonën Kadastrale Nr.8130, me sipërfaqe prej 78.94 m², e ndodhur në Tiranë, Adresa: Rr. Cemal Stafa, Shkalla 1, Kati 2, Ap.37, për shpënjjen e detyrimit në favor të kreditorit Rezik Cepeli, për shumën 10400 USD dhe 139742 lekë. Çmimi llogaritet me cilin filon ankandë është në shumën 1480125 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e njëzetë e pesë) lekë, e paracaktuar në raport vlerësimit e bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr. 5812 datë 27.06.2017. Ankandë zhvillohet në datë 02.11.2017, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Oendra Torre Drin, K12, Nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682999471, 0684054605, email : ermirgodaj@zyraparbarmit.com

Nga 29 tetori, programi "WebChat i Education USA" në ndihmë të të interesuarve

Voltiza Duro

Zyra konsullore e Ambasadës Amerikane: Procedura për të studiuar në SHBA

"Ja 5 hapat që duhet të ndjekin aplikantët"

Zyra Konsullore e Ambasadës Amerikane në bashkëpunim me "Education USA Albania" mbajti një prezantim për studimet në SHBA me nxënësit e gjimnazit "Petro Nini Lurasi" në kryeqytet. Të interesuarit u njohën me hapat që duhet të ndjekin për të fituar të drejtën e studimit në një prej programeve të parapëlqyera në Amerikë. I pranishëm në këtë takim ishte dhe zëvendëskonsulli Patrick Smith, i cili foli mbi procedurën e vizave dhe intervistën që aplikantët do duhet të kalojnë për t'u pranuar. Ndërsa Aida Hudhri, këshilluese në Qendrën Informative të Arsimit Amerikan në Shqipëri shpjegoi për gjimnazistët 5 hapat kryesorë që duhet të ndjekin për të aplikuar në një nga universitetet amerikane. Gjithashtu, në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane bëhet me dije se që prej datës 29 tetor, "Education USA" do t'u vijë në ndihmë të interesuarve edhe nëpërmjet një programi "Webchat", ku specialistët përkatës do japin përgjigje për çdo paqartësi që mund të ketë një maturant apo student në lidhje me aplikimet në universitetet amerikane. Ky panel do të orientojë nxënësit për opsionet dhe mundësitë që kanë për të studiuar në Shtetet e Bashkuara, duke i ndihmuar të arrijnë objektivat për të ardhmen. Çdo vit një numër i konsiderueshëm maturantësh dhe studentësh nga Shqipëria kërkojnë të ndjekin studimet bachelor dhe master në USA. Në këto universitete mund të aplikojë çdo i interesuar që përmbush kriteret e pranimit, të vendosura nga vetë institucioni i arsimit të lartë, ku do të vazhdojë studimet. Secili universitet apo kolegji i vendos vetë kriteret e pranimit dhe afatet e aplikimit. Prandaj hapi i parë është



Specialistët në takimin me gjimnazistët

- HAPAT PËR TË APLIKUAR PËR STUDIME NË SHBA:**
- Shqyrto alternativën më të mirë për arsimim.
 - Përfundo dokumentacionin për aplikim.
 - Financo studimet, duke aplikuar për bursë.
 - Apliko për vizë studentit.
 - Përgatit udhëtimin për në USA.

APLIKIMI PËR STUDIME NË SHBA

"Së pari, të interesuarit duhet të shqyrtojnë alternativën më të mirë për arsimim e më tej të përfundojnë dokumentacionin për aplikim. Pas kësaj, aplikantët duhet të financojnë studimet duke aplikuar për bursë e më tej duke aplikuar për vizë studentit. Pas plotësimit të hapave të pikave të mësipërme, studentët duhet të përgatisin udhëtimin për në USA. Instruktorët pranë Qendrës Informative të Arsimit Amerikan i ndihmojnë të interesuarit edhe në formulimin dhe hartimin e curriculum vitae, letërës së motivimit, letrave të rekomandimit, eseve", u shpreh Aida Hudhri.

PROGRAMI "WEBCHAT"

Në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane bëhet me dije se që prej datës 29 tetor, "Education USA" do t'u vijë në ndihmë të interesuarve edhe nëpërmjet një programi "Webchat", ku specialistët përkatës do japin përgjigje për çdo paqartësi që mund të ketë një maturant apo student në lidhje me aplikimet në universitetet amerikane. Ky panel do të orientojë nxënësit për opsionet dhe mundësitë që kanë për të studiuar në Shtetet e Bashkuara, duke i ndihmuar të arrijnë objektivat për të ardhmen.

përgjigjedhja e universitetit për të ditur çdo informacion në lidhje me këtë të fundit. Aplikantët duhet të njohin

paraprakisht kriteret e pranimit për fusha të ndryshme studimi. "Së pari, të interesuarit duhet të shqyrtojnë

alternativën më të mirë për arsimim e më tej të përfundojnë dokumentacionin për aplikim. Pas kësaj, aplikantët duhet të financojnë studimet duke aplikuar për bursë e më tej duke aplikuar për vizë studentit. Pas plotësimit të hapave të pikave të mësipërme, studentët duhet të përgatisin udhëtimin për në USA. Instruktorët pranë Qendrës Informative të Arsimit Amerikan i ndihmojnë

të interesuarit edhe në formulimin dhe hartimin e curriculum vitae, letërës së motivimit, letrave të rekomandimit eseve", u shpreh Aida Hudhri. Gjithashtu, shumë universitete ofrojnë bursa të pjesshme apo të plota e këto mundësi përjavësohen me mundësi të ndryshme në faqen zyrtare në internet.

LOTARIA AMERIKANE

Që prej datës 18 tetor ka rifilluar aplikimi për Lotarinë Amerikane, që do të zgjasë deri në datën 22 nëntor të këtij viti. Të gjithë ata që kanë bërë regjistrimin para 18 tetorit duhet ta ribëjnë edhe njëherë, sepse i pari nuk njihet si i vlefshëm. Individitë, të cilët bëjnë më shumë se një regjistrim gjatë periudhës së re të regjistrimit do të skualifikohen. Aplikantët mund të regjistrohen elektronikisht në faqen zyrtare të E-DV, state.gov, gjatë periudhës së re të regjistrimit. Udhëzimet e DV gjithashtu janë në dispozicion në faqen zyrtare të Departamentit të Shtetit Amerikan në ose në faqen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë.

LOTARIA

Të gjithë ata që kanë bërë aplikimin për Lotarinë Amerikane para 18 tetorit duhet ta ribëjnë edhe njëherë, sepse i pari nuk njihet si i vlefshëm. Individitë, të cilët bëjnë më shumë se një regjistrim gjatë periudhës së re të regjistrimit do të skualifikohen.

SHKURT

AKU bllokoi 10 subjekte, 9 të tjera gjobiten

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bërë bllokimin e aktivitetit për 10 subjekte të tregutit të mishit dhe ka gjobitur 9 të tjera në vlerën 1750000 lekë, pasi nuk plotësonin standardet e paracaktuara. Në kuadër të nismës për disiplinimin e tregjes së kafshëve dhe tregimit të mishit, AKU ka bërë konfiskimin e 434 kilogramë peshku dhe 81 kilogramë mishi, të cilat tregtoheshin jashtë kushteve higjieno-sanitare. Gjithashtu, është bërë paralajmërimi i 4 subjekteve të tjera, ndërkohe që në bashkëpunim me policinë është bërë konfiskimi i pajisjeve të një pike tregtimi tek Ura e Institutit në kryeqytet.

Bashkia e Tiranës mbjell 150 pemë në Liqenin e Thatë

Bashkia e Tiranës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka nisur gjelbërimin e zonës së Liqenit të Thatë, ku u mbollën 150 pemë e shkurre të para nga 500 që do mbillen në total në këtë zonë. I pranishëm në këtë nismë, Veliaj theksoi se periudha e vjeshtës deri në dimër do të shfrytëzohet nga Bashkia e Tiranës për të thyer rekordin e vjetshëm, me mbi 50 mijë pemë të mbjella. Gjithashtu, kryetari i bashkisë njoftoi se të gjithë ata që kanë zënë hapësirat apo kanë ndërtaur në territorin e Parkut të Liqenit, kanë edhe dy javë afat për t'u larguar vetë, në të kundërt do të jetë bashkia ajo që do të ndërhyjë.

FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në komunitet në Shqipëri, shpall **Thirrjen Nr.1 për Aplikime për Grants**.

Organizata Joffitprurëse (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Grantëve të këtij Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr.1, e cila do zbatohet në qarqet **Durrës, Shkodër dhe Fier** dhe do të qëndrojë e hapur nga data 23 Tetor deri në datën 19 Nëntor 2017, ora 17:00. Inkurajohen të aplikojnë organizata me seli në qarqet e mësipërme dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkitë Qendër Qarku (Durrës, Shkodër, Fier) por dhe të bashkitë e tjera (psh. Krujë, Malësi e Madhe, Lushnje, etj.), apo njësitë administrative përbërëse.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto qarqe, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-apikimi me një organizatë lokale/aktivistë lokale duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë dy lloj grantesh:

- Grantë deri në **15.000 €** (2 për qarkun Shkodër, 1 për qarkun Durrës dhe 1 për qarkun Fier) do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të kockicioneve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe rritjen e besimit të ndërsjellë dhe; b) Përmirësimin e ndërvëprimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, antarë të mekanizmave lokale të referimit, për rritjen e cilësisë së masave parandaluese dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Periudha e zbatimit të projektit: deri në 18 muaj
- Grantë deri në **5.000 €** (nga 2 grante për secilin qark) do të jepen për projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneritëve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus ngritjen, si iniciativë në fushën e zgjidhjes së konfliktit, ndërgjegjësimin, pasqatë e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun ruqor, buzinën dhe krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore, krimet homofobike, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Periudha e zbatimit të projektit: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime që mund të shkarkohen nga linku <http://www.cp-project.al/web/grants> dhe do të dorëzohen elektronikisht në adresën grants@cp-project.al.

Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al>

Studio Permbarimore "SHKRELA"
do të zhvillojë Ankandin e dyte për pasurite:

a) "Apartament", me sipërfaqe totale 77.36 m², me nr. Pasurie 6/121+1-2, e ndodhur në zonen kadastrale Nr. 8534, Volumi 5, Faqe 138, e ndodhur në Lagja 16 Prilli, Fier, ne pronesi te Vasillaq Tefi Zhaka.
Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 16.028.88 (gjashtembdhjetë mijë e njëzetë e tete pike tetëdhjetë e tete) Euro.

b) "Apartament", me sipërfaqe totale 62.2 m², me nr. Pasurie 6/121+1-4, e ndodhur në zonen kadastrale Nr. 8534, Volumi 5, Faqe 140, e ndodhur në Lagja 16 Prilli, Fier, ne pronesi te Vasillaq Tefi Zhaka dhe Lefteri Vangjil Zhaka, Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 12.887.84 (dymbdhjetë mijë e tetëdhjetë e tetëdhjetë e shtatë pike tetëdhjetë e kater) Euro.

c) "Apartament", me sipërfaqe totale 74 m², me nr. Pasurie 6/36+1-4, e ndodhur në zonen kadastrale Nr. 8534, Volumi 6, Faqe 148, e ndodhur në Lagja 16 Prilli, Fier, ne bashkëpronesi te Vasillaq Tefi Zhaka dhe Lefteri Vangjil Zhaka, Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 15.332.8 (pesëmbdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pike tete) Euro.

d) "Apartament", me sipërfaqe totale 51 m², me nr. Pasurie 116/71+1-31, e ndodhur në zonen kadastrale Nr. 2291, Volumi 25, Faqe 174, e ndodhur në Kryemadhen, Kavaje, ne pronesi te Vasillaq Tefi Zhaka, Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 13.440 (tremdhjetë mijë e katerqind e dyzete) Euro.

Pasurite jane ne bashkëpronesi te Vasillaq Zhaka dhe Lefteri Zhaka dhe te hipotekuara ne favor te bankes.

Ankandi i dyte zhvillohet me date 26.10.2017, ora 16.00 ne ambientin e Studios Permbarimore Shkrela me Adrese Rruga Biv, Zogu i I, Pall. "Agimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tiranë.

Blutë sekuestruan 220 rrënjë bimë narkotike, 146 kg kanabis, 1 automjet dhe 25 telefona

Zbulohet tuneli me drogë afër Rinasit, në pranga 7 persona

Ina Allkanjari

Policia e Tiranës në bashkëpunim me atë të Durrësit kanë finalizuar operacionin "Muzgu", duke zbuluar një tunel me drogë në zonën mes Fushë-Prezës dhe Valiasit. Gjatë aksionit policor u sekuestruan dhjetëra bimë narkotike, ndërsa 7 persona u arrestuan. Mësohet se organizatori i grupit ishte një ish-punonjës policie. Ndërkohë, priten që Policia e Shtetit të marrë masa ndaj disa oficerëve të policisë që ishin përgjegjës për zonën.

OPERACIONI "MUZGU"

Në datë 21 tetor 2017, forcat policore sekuestruan 220 bimë të dyshuara narkotike e llojit kanabis sativa dhe 146 kg bimë e dyshuar kanabis e futur në thasë, e cila gjendej në thellësinë e një tuneli. Në kuadër të operacionit "Muzgu", Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë në bashkëpunim me atë të Durrësit dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë të mundur identifikimin, gjetjen, kapjen dhe arrestimin në flagrancë të 7 shtetasve dhe procedimin në gjendje të lirë për 10 shtetas të tjerë. Ndërkohë, drejtori i Policisë së Tiranës, Ardi Veliu, në një deklaratë për mediat zbardhi detajet e operacionit. Mësohet se kanë rënë në pranga shtetasi Nexhmi Kallari, 48 vjeç, lindur në Tiranë dhe banues në Çerek, Krujë, në rolin e organizatorit; Mariglen Kallari, 23 vjeç, lindur në Kamëz dhe banues në Çerek, Krujë, në rolin e organizatorit; Rexhino Kallari, 24 vjeç, lindur në Tiranë banues në Çerek, Krujë, në rolin e organizatorit; Gazmir Sala, 45 vjeç, banues në Laknas, Tiranë ndihmës; Bledar Sala, 26 vjeç, banues në Laknas, Tiranë ndihmës; Denaldo Sala, 26 vjeç, banues në Laknas, Tiranë ndihmës; Mehmet Domi, 18 vjeç, banues në Vorë, Tiranë ndihmës. Gjithashtu, janë proceduar në gjendje të lirë 10 shtetas. Drejtori i Policisë së Tiranës, Ardi Veliu bën me dije se shtetasit e sipërpërmendur që procedohen në gjendje të lirë janë personat e punësuar nga shtetasit e ndaluar nga Shërbimet e Policisë, me qëllimin e punimit të parcelës dhe përpunimit të bimës së dyshuar narkotike dhe përgatitjes për tregtim përkundër përfitimit të shumave monetare. U sekuestruan në cilësinë e provës materiale 220 rrënjë bimë e dyshuar narkotike e llojit kanabis sativa; 146 kg bimë e dyshuar narkotike e llojit kanabis sa-



Drejtori i Policisë së Tiranës, Ardi Veliu



Tuneli ku u sekuestrua droga

tiva; një automjet furgon e markës "Ford", i cili shërbeente për transportimin e punëtorëve; 25 aparate të ndryshme telefonike. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", "Kultivim i lëndëve narkotike" dhe "Moskallëzimi i krimin". Veliu shprehet se nga ana e shërbimeve policore po punohet për zbardhjen e plotë dhe hetimin e gjithanshëm të kësaj veprimtarie kriminale në fushën e narkotikëve.

SEKUESTRIMI

Në kuadër të operacionit "Muzgu", forcat policore sekuestruan 220 bimë të dyshuara narkotike e llojit kanabis sativa dhe 146 kg bimë e dyshuar kanabis e futur në thasë, e cila gjendej në thellësinë e një tuneli.

TË ARRESTUARIT

1. Nexhmi Kallari, 48 vjeç, në rolin e organizatorit.
2. Mariglen Kallari, 23 vjeç, në rolin e organizatorit.
3. Rexhino Kallari, 24 vjeç, në rolin e organizatorit.
4. Gazmir Sala, 45 vjeç, ndihmës.
5. Bledar Sala, 26 vjeç, ndihmës.
6. Denaldo Sala, 26 vjeç, ndihmës.
7. Mehmet Domi, 18 vjeç, ndihmës.

SHKURT

Trafik droge drejt Greqisë, kapet i riu

KORÇË - Një 29-vjeçar ka përfunduar në pranga, pasi ka tentuar të trafikojë drogë drejt Greqisë. Shërbimet e stacionit të Policisë Kufitare në Kapshticë, në vijim të punës së tyre për evidentimin dhe goditjen e rasteve të prodhimit, shitjes e trafikimit të lëndëve narkotike dhe arrestuar në flagrancë 29-vjeçarin Klajdi Beqir, banues në Korçë. Më datë 22.10.2017, ky shtetas u paraqit në dalje të Republikës së Shqipërisë, me automjetin tip "Opel Zafira" me targa AA304PT. Nisur nga dyshimet e shfaqura se në këtë mjet, mund të ishte fshehur lëndë narkotike, shërbimet e Policisë Kufitare dhe të Doganës bënë përzgjedhjen e tij për verifikim në vijën e dytë. Gjatë kontrollit të detajuar, përfshi edhe procesin e skanimit të kryer janë konstatuar në brendësi të dyshemesë dhe në feneret e pasmë të mjetit pako të dyshuara me drogë. Grupi hetimor gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale gjithsej 34 pako me pesë 61.4 kg kanabis sativa.

Vidhë varëse flori, arrestohet 27-vjeçari

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka arrestuar një 27-vjeçar, i cili ishte kthyer në tmerrin e femrave në këtë qytet. Bëhet fjalë për shtetasin, Kolë Prroni, banues në fshatin Bardhaj të njesisë Rrethina. Burime nga blutë e qytetit verior pohuan se i riu ka kryer dy vjedhje (të dokumentuara) brenda pak ditëve në Shkodër. Më 1 tetor të këtij viti, në lagjen "Vasil Shanto", Kol Prroni i ka vjedhur me forcë nga qafa një varëse flori shtetas L.P. Autori arriti të largojë me shpejtësi nga vendi i ngjarjes, duke i shpëtuar policisë. Gjithashtu, i riu dyshohet se është autor edhe i ngjarjes së ndodhur më 16 tetor të këtij viti në lagjen "Vojo Kushi", ku i ka vjedhur me dhunë nga qafa një varëse flori shtetas D.P. Materialet në ngarkim të 27-vjeçarit Prroni i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprën penale të "Vjedhjes".

Autorët qëlluan nga një makinë në lëvizje

Atentat në qendër të qytetit të Shëngjinit, plagosen rëndë dy të rinj



ka bërë krehjen e zonës, ndërsa ka ngritur pika kontrolli me qëllim identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve

të krimin. Në ndihmë të policisë së Lezhës kanë shkuar dhe dy grupe të FNSH-së së Shkodrës. Ndërkaq, dy të pla-

gosurit janë dërguar urgjentisht në spitalin rajonal të Lezhës, ku iu është dhënë ndihma e parë mjekësore. Bluzat e bardha të këtij spitali pohuan se dy të rinjtë ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Florjan Dushku (njihet si mbështetës i LSI-së) ka qenë i përfshirë edhe në një incident ditën e zgjedhjeve, ku dhe mbeti sërisht i plagosur. Për ngjarjen e 25 qershorit, policia shpalli në kërkim tre persona: Samuel Ndokën, Damian Ndokën (nipat e ish-deputetit socialist Arben Ndo-ka) dhe Gentian Markun.

LEZHË - Dy të rinj kanë mbetur të plagosur në një atentat në qendër të Shëngjinit. Burime nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Lezhës bënë me dije se rreth orës 18:30, persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me armë zjarri nga një makinë në lëvizje, duke lënë të plagosur shtetasit: Florian Dushkun 28 vjeç dhe Samet Bercajin 19 vjeç, të dy banues në Shëngjin. Mësohet se dy të rinjtë (të paarmatosur) ishin duke ecur më këmbë në trotuar kur janë qëlluar nga agresorët. Krismat e armëve kanë shkaktuar panik te banorët si dhe kanë alarmuar policinë, ndërsa atentatorët janë larguar me shpejtësi. Menjëherë në vendngjarje kanë mbërritur uniformat blu, të cilët kanë nisur hetimet. Policia

Çfarë duhet të dini para se të vendosni të përfitonit këtë pagesë

Si fitohet pensioni i reduktuar i pleqërisë

Llogaritja sa ju del masa, me shembuj konkretë

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 kur:

1. a) Kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92.

1. b) Nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfuturimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumëzimi që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfuturimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, është 0.6% në muaj. Aktualisht, sipas nenit 92, vitet e sigurimit janë 35 vite e 8 muaj, ndërsa në vitin 2017 do të jetë 36 vjet (me një rritje 4 muaj në çdo vit). Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfuturimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë, shumëzimi që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfuturimit të pensionit para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 43, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni është 0.6% në muaj. Për ta pasur më të qartë, masa e përllogaritjes e pensionit të reduktuar mbetet në po atë madhësi edhe me plotësimin e moshës për pension të plotë. Në rast se në shembullin e mësipërm, personi do të kishte dalë në pension 3 vjet para plotësimit të moshës, atëherë pensioni i tij do të reduktohej në një masë prej 21.6% (36 muaj * 0.6% = 21.6%). Në këto kushte, pensioni i tij nuk do të ishte 17,356 lekë në muaj, por 13,607 lekë (17,356 - 3,749 = 13,607 lekë). Për të gjithë emigrantët që plotësojnë moshën për pension, 'Patronato INAS ALBANIA' pa asnjë pagesë, asiston në të gjitha procedurat, plotëson modulët përkatëse dhe plotëson dosjen për pension. Po kështu, bëjmë edhe përllogaritjen e pensionit, sipas formulës elektronike që ne disponojmë. Moshë e daljes në pension në Itali dhe llogaritja e pensionit bazuar në legjislacionin italian për të lindur e drejta për përfuturim e pensionit të pleqërisë kërkohen dy kushte: së pari, një vjetërsi kontributive jo më

pak se 20 vjet dhe kushti i dytë është moshë, e cila bazuar në reformën "Monti", rritet sipas koeficientit të jetëgjatësisë dhe në rastin konkret, moshë është 66 vite e 7 muaj. Ashtu sikurse mund të gjykohej nga tabela, në vitin 2018, bëhet barazimi i moshës së pensionit

për gratë dhe për burrat, si dhe për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. Në vitin 2019 do të bëhet një rregullim tjetër, ku sipas ndryshimit të nivelit të jetëgjatësisë, do të ndryshojë edhe moshë e daljes në pension. Llogaritja e pensionit në Itali do të bëhet sipas shumë

së kontributive të derdhura për këtë periudhë. Për ata persona të regjistruar pranë INPS (Istituto Nacional i Sigurimeve Shoqërore) dhe që kanë paguar kontribute mbas datës 01.01.1996 (sistemi kontributiv) mund të përfuturojnë pension edhe me jo më pak se 5 vite kon-

tribute, por mbasi të plotësojnë moshën 70 vjeç. Nga 1 janari 2012, për punonjësit që posedojnë vjetërsi kontributive për të paktën 18 vjet deri më 31.12.1995 do të aplikohet sistemi i llogaritjes kontributive i bazuar në kuotat e pensionit, që i korrespondon vjetërsisë kon-

tributive të maturuar, duke filluar nga 01.01.2012. Pensioni llogaritet ekskluzivisht me sistemin e llogaritjes kontributive për punëtorët që nuk kanë vjetërsi kontributive më 1 janar 1996. Për të ushtruar alternativën e opionit është e nevojshme që punëtorët të kenë vjetërsi prej më pak se 18 vjet të kontributit të 31.12.1995 dhe mund të zbatojnë në moment, si opion, një vjetërsi kontributive me të paktën 15 vite, nga të cilat 5 që nga viti 1995. Të tilla fakultative nuk mund të ushtrohen nga ata që plotësojnë një vjetërsi kontributive të barabartë ose më të madhe se 18 vite deri më 31.12.1995.

PËR BURRAT

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Moshë	Vjetërsia e punës	Moshë	Vjetërsia e punës	Moshë	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	22	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v 6m	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	66v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	66v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	66v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	66v	35v 8m
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	66v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	66v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	66v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	66v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	66v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	66v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	66v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	66v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	66v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	66v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	66v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	66v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	66v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	66v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	66v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	66v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	66v 1m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2040 - 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	65v 10m	40v	65v 10m	40v	66v 10m	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	65v 11m	40v	65v 11m	40v	66v 11m	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	66v 1m	40v	66v 1m	40v	66v 1m	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049 - 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050 - 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051 - 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052 - 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053 - 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054 - 31.12.2054	66v 10m	40v	66v 10m	40v	66v 10m	40v
01.01.2055 - 31.12.2055	66v 11m	40v	66v 11m	40v	66v 11m	40v
01.01.2056 - 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

PËR GRATË

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Moshë	Vjetërsia e punës	Moshë	Vjetërsia e punës	Moshë	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v 6m	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v 6m	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v 6m	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v 4m	60v 2m	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v 4m	35v 6m	60v 4m	35v 6m
01.01.2017 - 31.12.2017	57v	35	60v 6m	36v	60v 6m	36v
01.01.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v 8m	36v 2m	60v 8m	36v 2m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	61v 0m	36v 4m	60v 0m	36v 4m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v 2m	37v 4m	61v 2m	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v 4m	37v 6m	61v 4m	37v 6m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v 6m	38v	61v 6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v 6m	35v 6m	61v 8m	38v 2m	61v 8m	38v 2m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v 6m	36v	61v 0m	38v 4m	61v 0m	38v 4m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v 6m	61v	38v 6m	61v	38v 6m
01.01.2027 - 31.12.2027	61v 6m	37v	62v 2m	39v 2m	62v 2m	39v 2m
01.01.2028 - 31.12.2028	61v 6m	37v 6m	62v 4m	39v 4m	62v 4m	39v 4m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v 6m	40v	62v 6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v 6m	38v 6m	62v 8m	40v	62v 8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v 6m	39v	62v 0m	40v	62v 0m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	63v 0m	40v	63v 0m	40v	63v 0m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	64v 2m	40v	64v 2m	40v	64v 2m	40v
01.01.2040 - 31.12.2040	64v 4m	40v	64v 4m	40v	64v 4m	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	64v 6m	40v	64v 6m	40v	64v 6m	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	64v 8m	40v	64v 8m	40v	64v 8m	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	64v 0m	40v	64v 0m	40v	64v 0m	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2049 - 31.12.2049						

Dyshohet për "larje hesapesh" mes bandave rivale Ekzekutohet me tri plumba 39-vjeçari shqiptar në Torino, në kërkim autorët

ITALI - Një 39-vjeçar shqiptar është ekzekutuar me armë zjarri në Torino. Mediat italiane raportojnë se ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e së dielës pak pas mesnate. Kanë qenë banorë të zonës, ata që kanë njoftuar policinë për të shtëna me armë zjarri rreth orës 03:30. Ngjarja ka ndodhur në një lokal në Torino dhe sipas dëshmitarëve, kanë qenë dy persona të paidentifikuar që qëlluan me armë ndaj shqiptarit 39-vjeçar. Ky i fun-

NGJARJA

Ngjarja e rëndë në Torino të Italisë ku humbi jetën një 39-vjeçar shqiptar ndodhi në një lokal, ku dy persona, identiteti i të cilëve nuk bëhet akoma i ditur, qëlluan në drejtim të tij. Autorët kanë qëlluar tri herë mbi viktimitë, i cili si pasojë e plagëve të marra ndërroi jetë.

dit, identiteti i të cilit nuk bëhet ende i ditur, mbeti i plagosur në gjendje të rëndë dhe u dërgua në spital, ku dhe fatkeqësisht ndërroi jetë. Policia italiane thotë se autorët qëlluan tri herë me armë të kalibr 45 dhe janë larguar në drejtim të padi-

tur. Hetuesit dyshojnë se shkak i ngjarjes mund të jenë larje hesapesh mes bandave rivale shqiptare. Po ashtu, në tetor është shënuar një tjetër atentat me armë zjarri ndaj dy shqiptarëve. Ngjarja ka ndodhur në komunën San Miniato në



lajmëruan menjëherë policinë dhe u larguan nga vendi ku u dëgjuan të shtënat. U mësua se makina me të cilën udhëtonin dy shtetasit shqiptarë është bllokuar në mes të rrugës nga dy automjete të tjera, nga të cilat është hapur zjarr kundër tyre. Ndonëse të gjithë janë larguar nga vendi i ngjarjes, pak orë pas të shtënavë një shtetas shqiptar 34-vjeç ka kërkuar ndihmë mjekësore. Sipas deklaratës së autoriteteve italiane, ai është një nga protagonistët e atentatit me armë zjarri. Ndërsa policia ka marrë në pyetje shqiptarin, mediat nuk e përjashtojnë mundësinë e atentatit për shkak të larjes së hesapeve mes dy bandave rivale, pistë të cilën po e heton edhe policia.

Policia: Personat janë jashtë rrezikut për jetën, një në spital

Egla Xhemali

ZVICËR

Një përlëshje masive ka ndodhur në Lugano mbrëmjen e së premtes mes shqiptarëve dhe italianëve. Më shumë se 10 persona u përfishin në një sherr, i cili ka agruar deri në përdorimin e armëve të ftohta, (thika) duke shkaktuar plagosjen e shtatë personave. Sipas mediave vendëse, gjatë përlëshjes të përgjakshme në një lokal të Luganos, një burrë iu sul me thikë disa personave. "Ngjarja e rëndë ka ndodhur mes të premtes dhe të shtunës, ndërsa agresori ka ikur në drejtim të paditur", shkruan media zvicerane "sda.ch". Ende nuk bëhen të ditura motivet e kësaj ngjarjeje të rëndë, që fatmirësisht nuk pati viktima. Mes të plagosurve janë tre shqiptarë, tre italianë mes moshave 23 deri 27 vjeç dhe një 22-vjeçar zviceran. Njëri është dërguar me ambulancë në spital, ndërsa të tjerët kishin plagosje në dorë dhe këmbë. Sipas policisë së Tesinit, të plagosurit ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

PRECEDENTËT

Para disa muajsh një tjetër sherr i bujshëm ka ndodhur mes shqiptarëve dhe italianëve mbrëmjen e së premtes në një pikë fast-foodit të "Mc Donald's" në Prato për shkaqe krejt banale. Mediat italiane raportuan se shkak është bërë një cigare. Një 20-vjeçar shqiptar me banim në Montemurlo, i cili ishte klient në fast-food i ka kërkuar një

Përlëshje me thika në Lugano të Zvicrës, plagosen tre shqiptarë

Agresori goditi dhe tre italianë e një zviceran



LAJMI

"Ngjarja e rëndë ka ndodhur mes të premtes dhe të shtunës, ndërsa agresori ka ikur në drejtim të paditur", shkruan media zvicerane "sda.ch". Ende nuk bëhen të ditura motivet e kësaj ngjarjeje të rëndë, që fatmirësisht nuk pati viktima.

cigare një punëtori të fast-foodit. Ky i fundit i është përgjigjur negativisht, duke i thënë se i kishte konsumuar dhe nuk kishte më. Kaq ka mjaftuar që të nisë debati mes tyre deri në fyerje dhe më pas përplasje fizike. Në ndihmë të shqiptarit kanë shkuar edhe dy shokë

e tij që e shoqëronin. Sherri i janë bashkuar edhe punëtorët e tjerë të ndihmë të kolegut të tyre. Ndërsa një vajzë kliente e gjendur në vendin e gabuar është qëlluar me një shishe kokës. Bilanci përfundimtar, 6 persona në urgjencën e spitalit. Tre shqiptarë dhe tre punon-

jës të "Mc Donald's". Po ashtu, para pak kohësh Vegevano u përfishi në grindje, luftë dhe plagosje. Në dhomën e urgjencës së spitalit civil të Vegevano-s gjatë një nate është thirrur policia, me kërkesë të punonjësve të shëndetit, që sinjalizuan praninë e disa pacientëve të plagosur me thikë. Njësia e komanduar nga kapiteni Rocco Papaleo ka rindërtuar skenën që ndodhi rreth orës një të natës jashtë një klubi në rrugën "Rocco Vecija", zona kryesore e jetës së natës së këtij qyte-

7 TË PLAGOSUR

Në përlëshjen që ndodhi në Lugano të premten, policia bën me dije se kanë plagosur tre shqiptarë, tre italianë mes moshave 23 deri në 27 vjeç dhe një zviceran 22-vjeçar. Të shtatë të plagosurit kanë marrë plagë në gjymtyrë, megjithatë asnjëri prej tyre nuk është në gjendje të rëndë.

ti. Ndër pesë personat e përshirë në një rrahje, dy janë marokenë të moshës 22 dhe 23 vjeç dhe tre shqiptarë: 28, 23 dhe 22 vjeç, të gjithë me banim në Vegevano. Mosmarrëveshja erdhi si pasojë e një rivaliteti ndërmjet grupeve të të huajve për "arsye sentimentale", që lidheshin me një moshatare italiane, e fejuara e njërit prej dy afrikano-veriorëve. Marokeni 23-vjeçar e kishte gjetur të dëmtuar mjetin e tij "Audi", duke fajësuar për këtë dëmtim rivalët e tij shqiptarë.

SHKURT

Seks me minorene dhe drogë në qendrën e emigrantëve, kapen pesë shqiptarë

ITALI - Bënin festa droge e seks me minorene dhe vendi i zgjedhur për këto festa të çmendura ishte një rezidencë. Por, jo një dosido, Felicioni, një strukturë në Roseto të Abruzzos (Teramo), përballë detit, me pishinë, e cila pret prej vitesh 124 emigrantë. Të gjithë azilkërkues. Në pranga kanë përfunduar pesë shqiptarë në përfundim të një hetimi të gjatë të nisur që në muajin prill me arrestimin e njërit prej tyre, të cilit iu gjetën 40 gramë kokainë. Mediat italiane kanë zbuluar të tjera detaje për bandën me shqiptarë të kapur 5 ditë më parë. Karabinierët kanë kuptuar se mund të bëhej fjalë për një rreth të gjerë trafik, të cilin e kanë zbuluar me hetime në terren, përgjime telefonike, ambientale dhe filmimet. Një bandë e vërtetë, në të cilën bënin pjesë Alban Guga, 23 vjeç dhe Bruno Xhaysa, 28 vjeç, të dy rezidentë në Roseto. Gëzim Papa, 29 vjeç; Viktor Gjeci, 23 vjeç dhe Bledar Laçi, 29 vjeç, rezidentë në Rutigliano (Bari), të gjithë të gjykuar disa herë. Të pesë shqiptarët kishin organizuar një xhiro të shpërndarjes së kokainës dhe marijuanës mes Rosetos dhe rrethinave dhe shpesh takimet me blerësit (dhjetëra e dhjetëra të rinj edhe minorene, të gjithë të fotografuar dhe të filmuar nga karabinierët) bëheshin pikërisht brenda rezidencës "Felicioni", ku personat nën hetim prenontonin dhoma dhe organizonin festa të vërteta me baze droge e seks. Një disa raste vajzat që merrnin pjesë në takime, duke mos pasur para e paguanin kokainën dhe marijuanën me favore seksuale. Akuzat për 5 shqiptarët janë për shpërndarje droge të rrethana të rënduara për shkak të moshës minorene të klientëve (për dy shqiptarët rezidentë në Roseto) dhe shpërndarje e zhatje e rëndë (për shqiptarët rezidentë në Pulia). Viktimat e zhatjes ishin dy shqiptarët rezidentë në Roseto, të cilët nga tre shqiptarët e Pulias kishin marrë 200 gramë kokainë (me vlerë rreth 10 mijë euro), por pa u paguar.

NJOFTIM

Studio Përmbarimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e 1 (Parë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr.20/55+1-17, vol.5, faqe 87, Z.K.8571, e apartament, me sipërfaqe totale 74m2, e ndodhur në Lagjen "Kongresi" Lushnje, çmimi 2.400.000 lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 25.10.2017 në ambientet e Studios Përmbarimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Në datë 26.10.2017 në orën 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhë, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë se paluajtshme të llojit "Apartament" me sipërfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, në zonen kadastrale 1664, me adresë Lagja "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushë Krujë.Çmimi në ankand të pare është në vlerën 1,945,244.8 (një milion e nentëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e dyzet e kater pike tete) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Në datë 25.10.2017 në orën 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhë, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë se paluajtshme të llojit "Apartament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, në zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur në Lagja 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5. Ure Vajgurore Berat.Çmimi në ankand të dyte është në vlerën 1,568.000 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tete mije) lekë.


DEBATI PER KISHEN REAGIMET

Ministria e Kulturës: Shkuam në kishën e Labovës për inspektim, ndjesë për keqkuptimin

Kisha Ortodokse përplasat me Ministrinë e Kulturës

"Zhvilluan meshë pa dijeninë tonë, shkelën ligjin"

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë proteston kundra Ministrisë së Kulturës për përdorimin e Kishës Ortodokse të Labovës së Kryqit nga tre priftërinj katolikë nga Italia, që së bashku me një grup turistësh italianë, kryen aty "meshën e parë". E pranishme në këtë ngjarje ishte dhe drejtoresha e Institutit të Monumenteve të Kulturës, Arta Dollani, ndërkohë që ende vazhdojnë të kryhen punime plotësuese për restaurimin e këtij monumenti. "Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë nuk pati asnjë dijeni rreth kësaj ngjarjeje. Protestojmë për këtë shkelje të re të Ligjit 10057 dt. 22.1.2009, neni 23, paragrafi 2: 'Shteti mund të marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interese madhore dhe vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë", shkruhet në reagimin e kishës. Sipas tyre, është një fakt i pranuar ndërkombëtarisht se shteti nuk ka kompetencë të japë leje në mënyrë arbitrare tek kisha apo fe të tjera, që të përdorin një objekt ortodoks kulturi. Iniciativa të tilla të pabërgjegjshme janë shkelje e hapur e lirisë fetare dhe cenojnë bashkëjetesën paqësore të komuniteteve fetare në Shqipëri. Ndërkaq, Kisha Ortodokse Autoqefale ka theksuar faktin se nuk do të reshtë kurrë së theksuari të drejtat e saj, siç ato përcaktohen qartë nga Ligji 10057, neni 22, paragrafi 2: "Shteti do t'i kthejë dhe kompenzojë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të gjitha pronat, me përparësi objek-



tet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qen-

dra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit ortodoks dhe përbëjnë historinë e

këtij komuniteti, si objektet e kultit, manastiret e shenjtë, pasuritë, arkivat e saj të

konfiskuara nga regjimi komunist, në përputhje me legjislacionin në fuqi".

KONFIRMIMI
"Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës i konfirmojnë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë respektin maksimal dhe vullnetin për të thelluar bashkëpunimin e frytshëm mes institucioneve tona për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore dhe për ruajtjen e harmonisë fetare në territorin shqiptar".

REAGIMI I MINISTRISË

Menjëherë pas reagimit të kishës, Ministria e Kulturës nxitoi të theksojë se nuk ka pasur asnjë dijeni dhe nuk ka dhënë leje për zhvillimin e një aktiviteti të tillë. Në njoftim ata sqarojnë se në datë 19 tetor 2017, nga ana e IMK u organizua një inspektim i punimeve restauruese në kishën e Labovës së Kryqit, me praninë e drejtores së këtij instituti dhe ekspertëve restauratorë për të kryer një konsultë mbi problematiken konstruktive të monumentit. "Gjatë këtij inspektimi, në oborrin e kishës u vu re se po zhvillohej një meshë lutjesh lehtësimi për një grup personash me probleme të ndryshme shëndetësore dhe turistësh italianë. Vizita e turistëve dhe inspektimi i inxhinierëve kanë qenë krejt pa lidhje me njëra-tjetrën dhe thjesht një rastësi e çastit", shkruhet në deklaratën e Ministrisë së Kulturës. "Ministria e Kulturës shpreh keqardhjen për këtë keqkuptim të panevojshëm, ndonëse institucionet shtetërore nuk kishin dijeni për të. Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës i konfirmojnë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë respektin maksimal dhe vullnetin për të thelluar bashkëpunimin e frytshëm mes institucioneve tona për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore dhe për ruajtjen e harmonisë fetare në territorin shqiptar".

**BLUE
TOOTH**

THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA



te rejat
nga jeta
ipave

çdo të shtunë falas me

Policia: Procesi, i qetë dhe pa incidente madhore

Zgjedhjet lokale në Kosovë, pjesëmarrja në votime, 43%

Evidentohen 14 incidente në të gjithë vendin

Egla Xhemali

KOSOVË

Në Kosovë të dielën u mbajtën zgjedhjet lokale. Në këtë garë zgjedhore që zhvillohet për 38 komuna, u votua edhe për kryetarët e rinj dhe përbërjet e reja të asambleve komunale. Të drejtë vote kishin më shumë se 1 milion e 890 mijë qytetarë. Këtë të drejtë, sipas KQZ-së, e kanë shfrytëzuar 43.7 për qind e votuesve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka konfirmuar se votimet janë zhvilluar në 899 qendra të votimit, me 2,505 vendvotime. Për monitorimin e zgjedhjeve, KQZ-ja kishte akredituar rreth 33 mijë e 200 vëzhgues. Në zgjedhje kanë marrë pjesë 91 subjekte politike, prej tyre një koalicion, 35 parti politike, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur (qoftë për kryetarë komune, apo për këshilltarë në Kuvendet Komunale). KQZ-ja ka certifikuar 7,091 kandidatë, prej tyre 6,887 janë kandidatë për asambletë komunale, ndërkaq 204 kandidatë janë në garë për kryetarë komunash, shkruan "Rel". Në orën



19:00 janë mbyllur qendrat e votimeve për zgjedhjet lokale në Kosovë. Zgjedhjet kanë kaluar qetë, me

disa parregullsi, të cilat nuk e dëmtojnë procesin. Koalicioni i organizatave joqeveritare "Demokracia

në Veprim", që monitoron procesin zgjedhor, në një konferencë për media ka raportuar për parregullsi gjatë procesit zgjedhor. Ndër parregullsitë e vërejtura deri në orën 16:00 përmenden: tentimi për votim të shumëfishtë në 96 raste, votimi familjar në më shumë se 3 mijë raste, kurse 511 votues nuk e kanë gjetur emrin në listën e votuesve. Ndërkohë, policia e Kosovës ka vlerësuar se në aspektin e sig-

urisë, procesi zgjedhor në përgjithësi ka kaluar i qetë dhe pa incidente madhore, të cilat nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Referuar informacioneve zyrtare, policia njofton se janë evidentuar disa raste të ndryshme, por që me veprimet e menjëhershme janë menaxhuar nga autoritetet kompetente. Në të gjithë territorin e vendit janë evidentuar disa raste penale, si dhe katërbëdhjetë incidente të natyrave

të ndryshme, të cilat janë trajtuar dhe menaxhuar me sukses, shkruan 'TG'. Vlen të potencohet se Policia e Kosovës, në këtë rast zyrtarët kufitarë të PKK-Jarinje, dje rreth orës 12:40 në hyrje të Kosovës kanë ndaluar për kontroll një autobus udhëtarësh me targa KG, në të cilin janë gjetur mjete të dyshimta shpërthyes. Me këtë rast janë shoqëruar tre persona të dyshuar serbë për në stacion policor.

ZGJEDHJET

Në zgjedhjet lokale të së dielës në Kosovë, të drejtën e votës e kishin më shumë se 1 milion e 890 mijë qytetarë. Sipas KQZ-së, pjesëmarrja në votime ishte 43.7 për qind. Në garën zgjedhore morën pjesë 91 subjekte politike si në vijim:

- 35 parti politike
- 1 koalicion
- 30 Iniciativa Qytetare
- 25 Kandidatë të pavarur (për kryetar komune apo për kuvende komunale, në komuna të ndryshme).

EKSPLOZIVI

Në pikën kufitare në Jarinjë, policia ka ndaluar një autobus, që dyshohet të hynte nga shteti serb në Republikën e Kosovës, pasi aty kanë hasur në disa mjete, që dyshohet të jetë eksploziv plastik. Baki Kelani, zëdhënës në Policinë e Kosovës, tha për "REL" se tashmë janë arrestuar tre persona me shtetësi serbe. "Autobusi është ndaluar në pikën kufitare në Jarinjë. Si rezultat i veprimit të policisë janë shoqëruar në stacion policor tre persona të nacionalitetit serb për t'u marrë në pyetje dhe gjitha veprimet tjera do të ndërmerren në konsultim të ngushtë me prokurorët kompetentë", tha Kelani.

PORTA JUAJ HYRESE PER NE ROME DHE JO VETEM!



FLUTURONI PER NE ROME DHE ÇDO DESTINACION TJETER ESHTË I ARRITSEM FALË LIDHJEVE TONA. REZERVONI DERI NE 05 NENTOR

ROMA DUKE FILLUAR NGA €119
MADRID DUKE FILLUAR NGA €209
LOS ANGELES DUKE FILLUAR NGA €619

VAJTJE-ARDHJE TE GJITHA TE PERFSHIRA

ALITALIA.COM | +355 4 2230023 | AGJENCITE E UDHETIMIT



Çmimet, janë subjekt i disponueshmërisë në klasa të caktuara të rezervimit; janë për klasa ekonomike për udhëtimin vajtje-ardhje; përfshijnë gjitha taksat dhe shërbimet për blerjet e biletave në alitalia.com. Tarifa shtesë mund të aplikohet nga kanale të tjera shitjeje. Oferta është e vlefshme për nisjet nga Tirana në destinacionet e përzgjedhura. Biletat duhet të blihen deri më 05 Nentor 2017. Detaje të plota mbi kufizimet e mundshme mund të gjenden në alitalia.com.



TRAJTIM FALAS NË SPITALE



Ministria
Manastirliu: Paketë
e re radioterapie për
kancerin e gjirit

DITA BOTËRORE E OSTEOPOROZËS



Dieta e pasur
me kalcium
parandalon
sëmundjen

Lumturi Mërkuri:

◆ Në Shqipëri
konstatohen
rreth 550
raste të reja
në vit



Kanceri i gjirit mund të trajtohet lehtë, nëse zbulohet në kohë

Mjekja: Mos
neglizhoni mamografinë

• Përdorimet çudibërëse të mjaltit, sëmundjet që arrin të shërojë

Mjekja: Në Shqipëri konstatohen rreth 550 raste të reja në vit

Lumturi Mërkuri

Kanceri i gjirit mund të trajtohet lehtë, nëse zbulohet në kohë

"Mos neglizhoni mamografinë"



Mjeku popullor
Vili Merja

Viltiza Duro

Në Shqipëri kanceri i gjirit është tumori që haset më shpesh tek gratë, me rreth 550 raste të reja çdo vit. Në një intervistë të dhënë për suplementin "Life Pages" të "Gazeta Shqiptare", mjekja Lumturi Mërkuri u bën thirrje të gjitha grave që të ndërjegjësohen dhe të bëjnë kontrollin e gjirit, sepse nëse arrijnë ta zbulojnë në fazë të hershme, mund të trajtohet.

Çfarë është kanceri i gjirit?

Kanceri i gjirit është një lloj tumori ku qelizat e gjirit rriten jashtë kontrollit. Kanceri i gjirit mund të fillojë në pjesë të ndryshme të gjirit dhe mund të përhapet jashtë tij nëpërmjet enëve të gjakut dhe enëve limfatike, pra duke dhënë metastaza. Të dyja sekset, si gratë, ashtu edhe burrat mund të preken nga kanceri i gjirit, edhe pse ky kancer është shumë më i zakonshëm te gratë.

Sa i përhapur është kjo sëmundje në vendin tonë? Në Shqipëri, ashtu sikundër në botë, kanceri i gjirit është kanceri që haset më shpesh tek femrat, sidomos tek ato mbi 50 vjeç. Kanceri i gjirit pozicionohet në krye të listës së incidencës dhe vdekshmërisë nga kanceri, krahasuar me llojet e tjera të kancerit te gratë në Shqipëri. Fus-

hatat e ndërjegjësimin dhe forcimi i kapaciteteve në kujdesin parësor kanë filluar të ndikojnë në përmirësimin e kapjes së kancerit të gjirit në kohën e duhur. Janë pakësuar rastet e kancerit të gjirit të lëna

shumë pas dore, të paraqitura në fazë të avancuara dhe të diagnostikuara me diametër mbi 2-5 cm.

Cilat gra janë më të rrezikuara nga kanceri i gjirit?

Kanceri i gjirit prek të gjitha gratë,

por disa gra janë në rrezik më të lartë për kancerin e gjirit sesa disa të tjera për shkak të historisë së tyre mjekësore, personale, familjare, ose për shkak të ndryshimeve të caktuara gjenetike.

Cilat janë disa nga faktorët që ndikojnë në kancerin e gjirit?

Studimet kanë treguar se rreziku për kancerin e gjirit është rezultat i një kombinimi faktorësh. Disa nga faktorët e rrezikut përfshijnë: moshën, ndryshimet në disa gjene, fillimin e hershëm të menstruacioneve, menopauza pas moshës 50-55 vjeç, shtatzënitë në moshë të madhe, moslindja e fëmijëve, historitë personale dhe familjare me kancer gjiri, përdorimi i mjekimit me hormone për një kohë të gjatë, apo trajtimi me reze të sipërfaqes së gjirit, mungesa e aktivitetit fizik, të qenit mbipeshë apo obeze pas menopauzës, pirja e duhanit apo alkoolit.

Si zbulohet kanceri i gjirit?

Femrat me kancer gjiri mund të mos kenë shenja fare dhe mund ta konstatojnë kancerin e gjirit vetëm pas një kontrolli rutinë. Ekzistojnë disa mënyra kontrolli që zbulojnë herët kancerin e gjirit, atëherë kur nuk është shfaqur asnjë shenjë dhe kur është shumë i trajtueshëm. Ato kanë shpëtuar me mijëra jetë grash në të gjithë botën. Ekzaminimet që përdoren sot për kapjen e hershme të kancerit të gjirit janë mamografia dhe ekzaminimi klinik i gjirit.

Çfarë është mamografia?

Mamografia kap kancerin e gjirit në fazë shumë të hershme. Rezultati i mamografisë zakonisht merret mbas disa javësh. Nëse mamografia është normale, duhet vazhduar bërja e saj sipas intervaleve kohore të rekomanduara. Nëse mamografia është e parregullt nuk do të thotë gjithmonë se ka kancer. Për këtë duhet të bëhen teste shtesë dhe kontrolli nga një specialist i gjirit apo një kirurg.

Cilat janë disa nga ekzaminimet

FAKTORËT

Studimet kanë treguar se rreziku për kancerin e gjirit është rezultat i një kombinimi faktorësh. Disa nga faktorët e rrezikut përfshijnë: moshën, ndryshimet në disa gjene, fillimin e hershëm të menstruacioneve, menopauza pas moshës 50-55 vjeç.

EKZAMINIMET

EKO e gjirit është një ekzaminim, i cili rekomandohet për ato femra që kanë gji të dendur, kanë dëmtim që nuk interpretohet qartë me anë të mamografisë, kanë mbushje të gjirit me silikon dhe vetëm pak ind mund të përfshihet në mamografi.

REKOMANDIME MBI MOSHËN, LLOJIN E SHPESHTËSINË E TESTEVE DEPISTUESE PËR KANCERIN E GJIRIT

NËSE JU JENI:	JU DUHET:
40-49 vjeç	Ekzaminim klinik i gjirit nga një personel mjekësor i trajnuar së paku çdo 2 vjet.
50-69 vjeç	Ekzaminim klinik i gjirit nga personel mjekësor i trajnuar së paku çdo 2 vjet. Mamografi, çdo 2 vjet.
Mbi 70 vjeç	Filisi me mjekun se sa shpesh duhet të testoheni për kancer gjiri.



"TRAJTIM FALAS NË SPITALET PUBLIKE E JOPUBLIKE"

Manastirliu: Paketë e re radioterapie për kancerin e gjirit

Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka organizuar një sërë aktivitete. Ajo gjithashtu ka ndërmarrë masa për luftën ndaj kësaj sëmundjeje, ku vetëm pak ditë më parë ka ofruar një paketë të re radioterapie e trajtim falas në spitalet publike dhe jopublike. "Në vitin 2013, ne e gjetëm rimbursimin e diagnozës së kancerit të gjirit në nivelin e 71 milionë lekëve, ndërsa sot kjo shifër është dyfishuar. Janë 139 milionë lekë rimbursim, ndërkohë që barnat Antineoplazike dhe Imunosupresore, vetëm nga skema e rimbursimit financohen me 1.2 miliardë lekë. Një skemë nga e cila përfitojnë 3349 pacientë në vit", - u shpreh Manastirliu. Ajo gjithashtu bën me dije se dy njësitë e lëvizshme të mamografisë e kanë dyfishuar numrin e mamografive të kryera në vend për qëllime depistimi. Prej vitit 2015 dy mamografët e lëvizshëm kryejnë mbi 4.800 ekzaminime në vit. Leximi i këtyre mamografive tashmë mundësohet jo vetëm nga radiologët në institucionet publike shëndetësore, por edhe nga një operator ekonomik, në mënyrë që t'u shërbehet në kohë grave dhe vajzave që kryejnë këtë ekzaminim. Në rang vendi, mesatarja vjetore e ekzaminimeve është 9.300 mamografi në vit. Gjatë gjithë muajt tetor, mamografët e lëvizshëm kanë kryer diagnostikime falas për të gjitha gratë, si nismë e Ministrisë së Shëndetësisë.

e tjera të gjirit?

EKO e gjirit është një ekzaminim tjetër, i cili rekomandohet për ato femra që kanë gji të dendur, kanë dëmtim që nuk interpretohet qartë me anë të mamografisë, kanë mbushje të gjirit me silikon dhe vetëm pak ind mund të përfshihet në mamografi, si dhe ato që nuk mund të ekspozohen ndaj rrezëve

X (shtatzëna). Zakonisht, EKO e gjirit bëhet pas një mamografie. Ndërsa, ekzaminimi klinik i gjirit është një kontroll i gjirit i kryer nga një personel mjekësor i trajnuar, i cili mund të kapë kancerin në stadi të hershme. Ekzaminim klinik i gjinjve rekomandohet të bëhet 1 herë në vit ose së paku çdo 2 vjet. **Si bëhet vetëkontrolli i gjirit dhe**

Zakonet e shëndetshme ndihmojnë në ndalimin e përhapjes së mikrobeve

6 këshilla për të parandaluar gripin

Mënyra më e mirë është vaksinimi

Gripi stinor është një infektion akut viral shumë ngjitës. Rruga e transmetimit është ajo orofaringeale. Gripi stinor transmetohet direkt nga një person i sëmurë tek tjetri nëpërmjet kollitjes, teshtimave ose indirekt nga dhënia e dorës një personi të infektuar apo prekja e objekteve të ndotura me virusin e gripit stinor dhe më pas ata prekin sytë, gojën apo hundën. Viruset përhapen në ajër dhe nëpërmjet grimcave të ajrit kalojnë në grykë e hundë, shtohen dhe mbas 1-4 ditë japin shenjat e gripit stinor. Mënyra më e mirë për të parandaluar gripin sezonal është të vaksinoheni çdo vit. Por, zakonet e mira shëndetësore shpesh mund të ndihmojnë në ndalimin e përhapjes së mikrobeve dhe parandalimin e sëmundjes të gripit. Gjithashtu, ka edhe medikamente antivirale, që mund të përdoren për të trajtuar dhe parandaluar gripin. Ja disa këshilla për ta parandaluar këtë sëmundje:

Shmangni kontaktet e ngushta me njerëzit e sëmurë

Shmangni kontaktet e ngushta me njerëz të sëmurë. Kur jeni të sëmurë, mbani distancën tuaj nga të tjerët për t'i mbrojtur ata nga gripi.

Qëndroni në shtëpi kur jeni të sëmurë

Nëse është e mundur, qëndroni në shtëpi nga puna, shkolla dhe detyrat kur jeni të sëmurë. Kjo do të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së sëmundjes suaj te të tjerët.

Mbuloni gojën dhe hundën

kur duhet të fillojë?

Vetëkontrolli mujor i gjirit është një veprim shumë i thjeshtë, që çdo femër mund ta bëjë pa shumë mundim. Me lëvizje rrotulluese me dorë kontrollohen me radhë gjinjtë, deri në pjesën e sipërme të krahorit dhe sqetullat. Vetëkontrolli i gjirit rekomandohet të bëhet 1 herë në muaj, duke filluar që nga mosha 20 vjeç.

Në cilat raste duhet të shqetësohen femrat gjatë vetëkontrollit të gjirit?

Një femër duhet të shkojë menjëherë tek mjeku nëse vëren në gjinj ndonjë ndryshim si: një gjëndër apo kokërr në gji ose nën sqetull, trashje ose ënjtje e një pjese të gjirit, ndryshime të lëkurës së gjirit-skuqje, plagë apo dëmtime të tjera, skuqje, çarje apo trashje e lëkurës përreth thithit të gjirit, gropëzim i thithit të gjirit, rrjedhje nga gjiri përveç qumështit të gjirit, duke përfshirë edhe gjakun, çdo ndryshim në madhësinë apo formën e gjirit, si dhe dhimbje



Mbuloni gojën dhe hundën kur kolliteni ose teshtini. Mund të ndikojë që ata që janë përreth jush të mos sëmurën.

Pastroni duart

Larja e duarve shpesh do t'ju ndihmojë të mbrohni nga mikrobet. Nëse sapuni dhe uji nuk janë të disponueshëm, fërkoni duart me alkool.

Shmangni prekjen e syve, hundës ose gojës

Gripi shpesh përhapet kur një

person prek diçka që është e ndotur me mikrobe dhe më pas prek sytë, hundën ose gojën.

Praktikoni zakone të tjera të mira shëndetësore

Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e prekura shpesh në shtëpi, në punë ose në shkollë, sidomos kur dikush është i sëmurë. Flini gjumë mjaftueshëm, jini fizikisht aktivë, menaxhoni stresin, pini shumë lëngje dhe hani ushqim të mirë.

në gji.

Si trajtohet kanceri i gjirit?

Kanceri i gjirit trajtohet në disa mënyra si: ndërhyrjet kirurgjike, kimioterapia, terapia hormonale, terapia me rrezatim. Mënyra e trajtimit varet nga lloji i kancerit të gjirit dhe se sa është i përhapur ai. Njerëzve me kancer të gjirit shpesh u duhet të marrin më shumë se një lloj të trajtimi. Së fundi kanë hyrë edhe preparate, të cilat rrisin jetëgjatësinë për pacientët në faza të avancuara.

ISHP: 1 në 3 gra dhe 1 në 5 burra mbi 50 vjeç pësojnë thyerje kockash

Dieta e pasur me kalcium parandalon osteoporozën

Aktivitet fizik 3-4 herë në javë

Në Ditën Botërore të Osteoporozës, Instituti i Shëndetit Publik bën thirrje për më shumë kujdes në mbrojtjen e shëndetit të kockave. Sipas statistikave, 1 në 3 gra dhe 1 në 5 burra mbi moshën 50 vjeç pësojnë thyerje kockash nga kjo sëmundje, që në asnjë moment nuk duhet neglizhuar. Kjo "epidemi" e heshtur konsiston në humbjen e masës kockore e përparon në mënyrë graduale deri sa ndodh fraktura e parë.

Kush mund të preket nga osteoporozja?

Osteoporozja prek femrat dhe meshkujt. Frakturat janë më të pakta te meshkujt, por kur ato ndodhin, kanë një nivel më të lartë paafësie e vdekshmërie sesa te femrat.

Cilët janë faktorët kryesorë? Moshë - humbja e indit kockor në përgjithësi fillon pas moshës 40-50 vjeç. Kështu, me rritjen e moshës rreziku për osteoporozë shtohet.

Gjinia - gratë në mënyrë të veçantë, sidomos mbas menopauzës, janë më të rrezikuara për osteoporozë. Histori familjare - (familjarë të afërt, sidomos prindërit) me osteoporozë ose thyerje që rezultojnë pas një goditjeje apo rënieje fare të vogla tregojnë rrezik për osteoporozë.

Menopauza - gratë në menopauzë duhet të jenë më vigjilente për shëndetin e kockave të tyre.

Hypogonadizmi te meshkujt, ashtu si deficieti i hormoneve estrogen te femrat në menopauzë, deficieti i androgeneve te meshkujt rrit rrezikun për osteoporozë.

Përdorimi për një kohë të gjatë i disa medikamenteve si: kortizonikë, hormone të tiroides, atepileptikë, citostatikë etj.

Artriti reumatoid dhe disa sëmundje kronike si malabsorbimi, sëmundje kronike të mëlçisë, hyperthyroidizmi etj.

Por, disa prej faktorëve rrezikues për osteoporozën mund të mbahen nën kontroll, pra janë të modifikueshëm.

Këta faktorë përfshijnë:

Konsumin e lartë të alkoolit - njerëzit që pinë më shumë se 2 njësi në ditë alkool rrisin deri 40% rrezikun për



frakturë nga osteoporozja.

Pirja e duhanit - studimet tregojnë se ata që pinë duhan janë më të rrezikuar se ata që nuk pinë.

Indeksi i ulët i masës trupore - nëse

teporozë.

Deficieti në vitaminë D - vitamina D është esenciale, sepse ndihmon në përthithjen e kalciumit në gjak.

Aktiviteti e paktë fizik - njerëzit që

ja si dhimbja e lehtë, reduktimi i gjatësisë trupore me disa cm apo frakturat mund të jenë të lidhura me osteoporozën.

Si diagnostikohet osteoporozja?

agnoza osteoporozë.

Ja çfarë ndihmon në parandalim: Aktiviteti fizik

Kryerja e ushtrimeve të rregullta fizike luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe mbajtjen e masës kockore. Ato reduktojnë rrezimet dhe përmirësojnë rehabilitimin nga frakturat. Ushtrimet janë individuale, por përgjithësisht shumica e njerëzve ka nevojë për 30-40 minuta 3 deri 4 herë në javë.

Kalciumi

Marrja e kalciumit në sasi të mjaftueshme. Ushqimet e pasura me kalcium janë: qumështi dhe produktet e tij, perimet jeshile si brokoli, lakra jeshile etj.; disa fruta si portokalli, kajsia, fiqtë e thatë, arrat, bajamet, drithërat, peshku i konservuar dhe sardelet, lëngjet e frutave dhe uji mineral.

Vitamina D

Ekspozimi për 15 min në ditë në diell i duarve, krahëve dhe fytyrës është zakonisht i mjaftueshëm për prodhimin e vitaminës D për shumicën e njerëzve. Vitamina D mund të sigurohet edhe nga ushqimet dhe suplementet. Ushqime të pasura me vitaminë D janë vaji i peshkut, veza, mëlçitë, drithërat etj.

Dieta

Ndjekja e një stili të shëndetshëm jete është pjesë e kujdesit për kocka të shëndetshme. Mënjanimi i duhanpirjes, pirja e moderuar e alkoolit, si dhe mbajtja brenda kufijve të normës i peshës trupore janë disa faktorë të rëndësishëm. Kafeina dhe kripa mund të rrisin humbjen e kalciumit nga trupi dhe nuk duhet të merret në sasi të tepërta.

Rreziku

Çdo person duhet të jetë i vetëdijshëm për çdo faktorë rreziku personal që mund të ndikojë në shëndetin e kockave dhe të konsultohet me mjekun nëse është në rrezik. Cilat janë trajtimet për osteoporozën?

Në varësi nga rezultatet e testit të densitetit kockor, mjeku mund të japë medikamente dhe suplemente për të parandaluar humbjen e masës kockore.



< 19-20kg/m², kjo është e lidhur me humbjen e masës kockore dhe rritjen e rrezikut për fraktura.

Ushqyerja e varfër me kalcium dhe proteina, e cila rrit rrezikun për os-

bjëjnë jetë sedentare kanë më tepër mundësi për fraktura.

Cilat janë shenjat e osteoporozës? Osteoporozja nuk ka simptoma të dukshme. Megjithatë, disa shen-

Për vendosjen e diagnozës rekomandohet kryerja e testit të matjes së densitetit kockor (BMD test). Kur BMD testi i një personi është - 2.5 ose më i ulët, atëherë vendoset di-

Këshilla

Përdorimet çudibërëse të mjaltit, sëmundjet që arrin të shërojë

Mjalti përmban vlera të shumta ushqyese dhe medicinale e është përdorur që në lashtësi për vetitë e tij antibakteriale dhe antifungale. Më poshtë po japim disa nga efektet kurative të këtij ilaçi çudibërës.

I ftohti dhe gripi

Në shtëpi mund të përgatisni vetë një shurup kolle duke përdorur një filxhan me mjaltë cilësor, një lugë gjelle me lëng limoni dhe 2 lugë çaji me sherebelë. Shëron plagët

Mjalti bën punë edhe kundër djegieve të imëta, madje në shumë raste është më efektiv se trajtimet me antibiotikë. Mjalti ka një përmbajtje natyrale të disa substancave që funksionojnë si antibiotikë.

Problemet me tretjen

Konsumimi i mjaltit zgjidh problemet me diarrenë dhe paran-



dalon ulcerën, një prej sëmundjeve të rrezikshme që i kanoset njeriut. Për më tepër, mjalti është një probiotik natyral që stimulon rritjen e baktereve të mira në stomak, duke ofruar një mburojë të mirëfilltë natyrale.

Gjumë të qetë

Gjumi i qetë është thjesht një lugë gjelle me mjaltë larg. Kjo teori ka nevojë për më shumë studime, e megjithatë konkluz-

ionet e deritanishme thonë se mjalti përmirëson gjumin, duke i dhënë mëllçisë glikogjen ndërkohë që trupi pushon. Një gjë e tillë qetëson trurin dhe parandalon aktivizimin e kundërpërgjigjeve të stresit.

Flokë dhe lëkurë të shëndetshme

Falë aftësive shëruese, mjalti mund të përdoret edhe në flokë dhe lëkurën e thatë për t'i bërë më të shëndetshëm.



HUDHRA, zëvendësuese e antibiotikut

Për ata që vuajnë nga hipertensioni, do t'u mjaftonte të hanin një thelb hudhre dhe shumë shpejt do ta ndiejnë sërish mirë veten. Por nuk rekomandohet që hudhra të përdoret nga njerëz që e kanë tensionin e ulët, pasi do të keqësonin shëndetin e tyre. Ajo ndihmon edhe në qarkullimin në mënyrë të rregullt të gjakut. Mjekët rekomandojnë 2 thelpinj hudhre në ditë. Efekte pozitive ka dhënë përdorimi i hudhrës edhe në parandalimin e kancerit në stomak dhe në zorrën e trashë. Kanceri në zorrën e trashë është i përhapur te meshkujt dhe është vërtetuar se ata që kanë përdorur hudhra kanë pasur më pak mundësi për t'u

prekur nga sëmundja. Këshillohet që çdo ditë të hahen 3 deri në 10 thelpinj hudhre.

Për shkak të vetitë të saj dezinfektuese, hudhra ka dhënë rezultate të shkëlqyera te të sëmurët që vuajnë nga dhimbja e veshëve. Për këta

njerëz rekomandohen disa pika nga lëngu i hudhrës në momentin e dhimbjeve. Shumë shpejt ky lëng do të jepte efekte të menjëhershme në qetësimin e veshit. Po kështu, rezultate mjaft të mira ka dhënë në shërimin e gripit, kur ai është i shoqëruar me bllokim të hundëve apo dhimbje të grykëve. Një studim i kryer nga studiues amerikanë provoi se përbërësit e hudhrës mund të mbysnin 14 lloje të ndryshme bakteresh dhe mund t'i shkatërrojnë ato. Shumë e dobishme është hudhra edhe për të sëmurët që vuajnë nga astma dhe kolla. Përdorimi i saj ose lëngu që përftohet gjatë shtypjes lehtëson rrugët e frymëmarrjes dhe qetëson të sëmurin. Në Luftën e Dytë Botërore, lëngu i hudhrës ka ndihmuar në mjekimin e plagëve të rënda të marra gjatë luftimit. Edhe sot ajo vazhdon të japë efekte të shkëlqyera në shërimin sa më të shpejtë të plagëve, duke zëvendësuar kështu edhe antibiotikët.



Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së tetëmbëdhjetë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Tra-

jtitimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfillojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'ijapë përparësi kompensimit të trualtit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E TETËMBËDHJETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbimri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbimri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Shuk	Serreqi	Gjon	Serreqi	14900 m2 toke bujqesore	2644	168/1	13790	13790	ka vertetim nga dokumentat hipotekore, ka harte, ka urdher mosushtrim iniciative
Nush	Topalli	Ferdinand	Topalli	9000 m2 toke bujqesore	2236	443	9000	9000	ka note transkripti i ka harte, vendimi ka marre forme te prere
Nush	Topalli	Ferdinand	Topalli	12000 m2 toke bujqesore	2236	434	12000	12000	ka note transkripti i ka harte, vendimi ka marre forme te prere
Trashg. Bilali		Ahmet	Bilali	8906 m2 toke bujqesore	1867-1766	430	Mosnjohje e te drejtes se pronesise		ka flete regjistri ka Vfj Ka harte
Trashg. Bilali		Ahmet	Bilali	12000 m2 toke bujqesore	3243	397	Te mos njihet e drejta e pronesise		ka flete regjistri ka Vfj Ka harte
Gjon e Angjelin	Toska	Marije e Margerita	Toska	7500 m2 toke bujqesore	Mali Hebaj / 2565				
Elez	Saraci	Teuta	Gjyli	6000 m2 toke bujqesore	1157	230/1	6000	6000	ka flete regjistri ka vendim te meparshe m komisioni oni
Gjon e vellezer Serreqi		Gjon	Serreqi	50 dy + 23270 m2	2487	222/1	Mosnjohje e se drejtes se pronesise		ka note transkripti i ka harte
Ahmet	Hotaj	Sadik	Hotaj	250 m2 truall	8549	466	Mosnjohje e te drejtes se pronesise		ka vendim komiteti ekzekutiv, ka akt pronesie ka harte
Shuk	Serreqi	Gujem	Serreqi	9550 m2 toke bujqesore	1240-1526	204	9000	9000	ka vertetim nga dokumentat hipotekore
Roza	Marpali	Tonin	Marpali	60.3 m2 dyqan + truall	8592	407	60		ka note transkripti i ka harte
Enver	Mandija	Amarildo	Mandija	4040 m2 truall	8594	1-Dec	4040		ka vfj ka vertetim shpronesimi, ka harte
Jonuz	Meta	Skender	Meta	120 dy livadh dhe ograje	Velipoje / 3734	20	Mospranim Kerkese		ka vfj ka vertetim shpronesimi
Gjon	Gjeloshi	Nike	Gjeloshi	13400 m2 toke bujqesore	3072	474	Te mos njihet e drejta e pronesise , Ndryshimi n pjeserisht te vendimit nr. 481 dt 05.11.1996 per sip. E Kompensimit si me poshte: Kth= 3518 m2 truall, Moskthim = 918 m2 truall		ka flete regjistri ka vfj ka harte, ka vendim te meparshe m komisioni , 481 dt 05.11.1996
Mitro	Dritarja	Llabut	Dritaj	5000 m2 truall	Gruemire, Boric / 1244	97	5000	4140	ka vfj ka harte

Jakup	Dibra	Bakir	Dibra	pa siperfaqe	shkoder	245	Mbyllje procedimi	ka vertetim pronesia ka harte		
Daut	Rexhepi	Kujtim	Anamali	12 dy livadh	shkoder	258	Mbyllje procedimi	ka vertetim pronesia ka note transkripti nuk ka harte		
Mati	Pogu	Tonin	Pogu	pa siperfaqe	shkoder	281	Mbyllje procedimi	ka tapi (vertetim zotnimi), nuk ka vfi nuk ka harte		
Xhevdet	Miloti	Xhevdet	Miloti	3 dy truall	shkoder	282	Mbyllje procedimi	ka vfi ka harte ka vertetim kadastrre		
Halit	Anamali	Sami	Anamali	pa siperfaqe	shkoder	287	Mbyllje procedimi	ka vertetim kadastrre ka harte		
Sait	Tafili	Qemal	Tafili	dugaje pa siperfaqe	shkoder	286	Mbyllje procedimi	ka note transkripti		
Asllan	Bekteshi	Besnik	Bekteshi	dugaje pa siperfaqe	shkoder	273	Mbyllje procedimi	ka vertetim pronesia ka harte		
Mat	Doda	Tone	Pepaj	250 m2 truall	Dush Vau I Dejes/1575	435	Mos ndryshimi ne vendimit te komisionit	Vendimi nr. 378 I AKKP, I cili kthen sip. e njohur me v. 529, dt. 20.1.99 te Kesh. Qarkut, eshte marre pasi eshte shuqizuar me pare vendimi nr. 435 I qarkut dhe kthyer ceshtja per rishqyrtim me v. nr. 405, dt. 17.7.09 te Dr. Perri		
Adem	Burgaj	Hysen	Burgaj	9500 m2 truall + toke bujqesore	Gruemire, Kurt Kurtaj / 2343	98	9500	2500	ka vfi ka harte, ka vetetim pronesia	
Selim	Semaj	Dan	Semaj	400 m2 truall	Gruemire / 1871	78	400		ka vfi ka harte, ka vetetim kadastrre, ka parablerj e objekti	
Rakip ; Hamdi	Llazani	Muhamet	Llazani	9000 m2 truall	Koplik Kamice / 2068	79	9000	450	ka vfi ka harte	
Zeqir e Smajl	Cenaj	Skender	Cenaj	9700 m2 truall	Gruemire / 1871	80	9700	7204	ka vfi ka harte	
Vaso	Petro	Bogic	Veri	264 m2 truall	Gruemire / 1871	81	264		prona eshte ne bashkepronesi me shtetin ka akt njoftuni	
Rexhep	Macaj	Lutfije	Çukaj	8700 m2 truall	Bajze Kasttrat / 3982	83	8700	1160	ka vfi ka harte	
Mustaf	Bajraktari	Muhamet	Bajraktari	5200 m2 truall	Koplik / 2220	82	5200	2170	ka vfi ka harte	
Elez	Saraci	Teuta	Gjyli	9000 m2 toke bujqesore		1157	229/1	9000	9000	Vendimi 1325 I AKKP eshte marre pasi eshte shfuqizuar me pare v. 229/1 I qarkut dhe kthyer ceshtja per rishqyrtim .ka vertetim pronesia ka harte
Shevqet	Muka	Adnan	Muka	12250 m2 toke bujqesore		3506	183/1	10000	10000	ka vertetim pronesia ka harte, vendimi ka marre forme te prere
Shevqet	Muka	Adnan	Muka	30500 m2 toke bujqesore		1329	202	17500	17500	ka vendim komiteti ekzekutiv, ka dokument iprotektor, ka harte, vendimi ka marre forme te prere
Rexhep	Vruzha	Kudrete	Bejleri	23 m2 truall + ndertese		8591	383	23		ka vertetim pronesia ka flete regjistri ka harte, prona eshte njohur ne bashkepronesi
Gjone Vellezer Serreqi		Guljem	Serreqi	3900 m2 toke bujqesore		2565	163	3900	3900	ka note transkripti, ka vendim konfiskim i, ka harte, vendimi ka marre forme te prere
Preç	Shyti	Ndok	Kokaj	5000 m2 truall	Bajze Kasttrat / 3982		84	5000	600	ka vfi ka harte
Ujk	Tafili	Kol	Tafili	2500 m2 truall	Kastrat / 2112		85	2500	377	ka vfi, ka harte
Preke	Koka	Lule ; Ndue	Kokaj	8050 m2 truall	Ivanaj / 1989		86	8050		ka vfi, ka harte
Ramadan ; Bajram ; Hysen	Kukaj	Adil	Zeka	9 dy truall	Gruemire / 1871		87	9000	240	ka vfi ka harte ka akt njoftuni
Cub	Hebaj	Xhemal	Hebaj	2500 m2 truall	Reç, Shkrel / 3158		68	2500	2300	ka vertetim kadastrre ka harte
Dan	Hasanaj	Dan	Hasanaj	7500 m2 livadh + kullote	Gruemire / 1871		69	6100	1140	ka vertetim pronesia ka harte
Esat	Boksi	Xhelal	Boksi	8000 m2 truall	Gruemire / 1871		70	8000	7500	ka vfi, ka harte
Marash	Mala	Ndue	Veshtja	shtepi pa siperfaqe + 15 dy truall	Kalldrun / 2047		71	15000	10500	ka vfi, ka harte
Pjeter	Duka	Gjergj	Duka	shtepi pa siperfaqe + 28910 m2 truall	Shkrel /		72	28910	10891	ka vfi, ka harte

Opinion i Ditës

Nemanja Rujevic

Serbi, një kriminel lufte si docent

(Vijon nga faqja e parë)

... për krime lufte. Ajo luan me kartën nacionaliste.

Në të vërtetë Akademia Ushtrake serbe mund të ftojë kurdo e këdo "studiuues të njohur" si docent. Kjo është e shkruar në statutin e saj. Por, statuti tani po zbatohet me një kreativitet të veçantë. Oficerët e ardhshëm serbë do të marrin mësim nga Vladimir Lazarevic dhe dy komandantë të tjerë të njohur nga koha e luftës së Kosovës. Ministria e Mbrojtjes u ka ofruar aty-

lartë kishin punuar sistematikisht për "pastrimet etnike". Rreth 1000 kufoma të shqiptarëve të vrarë u gjenden pas luftës në katër varreza masive, pjesërisht qindra kilometra larg Kosovës. Lazarevic u lirua në vitin 2015 nga burgu, pasi kishte vuajtur dy të tretat e dënimit.

ZEMËRIM NË KOSOVË

"Çfarë mund t'u mësojnë këta njerëz oficerëve të ardhshëm? Si mund të dalësh para gjyqit të Hagës?" pyet e zemëruar, Anita Mitic, drejtoreshë e Iniciativës Rinore për të Drejtat e Njeriut, një organizatë joqeveritare rajo-

u ekzekutuan pa mëshirë. "Një nga leksionet në Akademinë Ushtrake mund të jetë se si mund të ekzekutohesh fëmijët, për të mbrojtur gjoja integritetin e Serbisë", shkroi Surroi në "Facebook". E gjitha kjo, kur kuadri ligjor nuk është problematik: Dënoshesh, vuan dënimin për fajin e bërë, del nga burgu e mund të jesh sërish anëtar i barabartë i shoqërisë: "Do të doja të dija, nëse njerëzit që e kanë vuajtur një dënim të caktuar janë të lirë apo jo?", pyet kryeministria serbe, Ana Brnabic. Por, bëhet fjalë për më shumë, shkruan portali kritik ndaj

hen moralisht, e kjo bëhet kur institucionet shtetërore nuk i mbështesin më ata", thotë Mitic në bisedë me "Deutsche Welle". "Ndryshe, kam frikë se këta njerëz trajtohen si heronj".

SONJA BISERKO, KOMITETI I HELSINKIT

Mesazhi nacionalist me sa duket mbërrin në destinacion: "Gjeneralët kanë mbrojtur vetëm vendin e tyre", thuhet në një nga komentet e lexuesve në "Facebook"-un e "Deutsche Welle"-s në serbisht. Shoqëria serbe me sa duket nuk del dot nga roli ekkzuliv i viktimës. Sot bëhet sërish



re pozicionin e docentit. Ministri i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, lëvdoi gjeneralët si "njerëz të jashtëzakonshëm" dhe deklaroi se kështu "vihet në vend padrejtësia që iu është bërë në vitet e fundit". Padrejtësi? Në vitet e luftës së Kosovës (1998-1999) u vranë rreth 10.000 civilë shqiptarë dhe u dëbuan gati 1 milion vetë nga provinca e atëherëshme serbe. Po ashtu, humbën jetën qindra civilë serbë në aksionet e guerilasve kosovare e gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, që i dhanë fund luftës. Për Vladimir Lazarevic, komandantin e atëherëshëm të trupës së Kosovës në ushtrinë serbe, lufta pati madje edhe një epilog tjetër: Tribunali i Hagës për krime lufte e dënoi atë me 14 vjet burg. Gjykata vërtetoi se Lazarevic së bashku me oficerë të tjerë të rangut të

nale. "Ajo çfarë kanë bërë ata është e ndaluar nga çdo konventë lufte. Kontributi i tyre i vetëm është turpi, me të cilin kanë mbuluar ushtrinë serbe dhe vendin".

LAZAREVIC U DËNUA NGA TRIBUNALI I HAGËS

Iniciativa Rinore ka reaguar edhe ndaj një kriminelit tjetër të luftës, që në Serbi gati u rehabilitua. Veselin Sljivancanin, që ka qenë i burgosur në Hagë për shkak të krimeve në qytetin kroat Vukovar merr pjesë rregullisht në debatet publike të partisë serbe të progresit. Kur aktivistët kërkuar të ndalnin një referat të Sljivancanin, përkrasitë e tij reaguan me goditje. Lajmi për punësimin si docent të Lazarevicit shkaktoi në Kosovë zemërim. Intelektuali i njohur kosovar, Veton Surroi, botues i "Koha Ditore", kujton një nga krimet e luftës të vitit 1999, kur 24 të rinj shqiptarë

qeverisë, Pescanik: "Me një gjest simbolik, politikanët e Beogradit duan të sinjalizojnë se vitet '90-të, - koha e luftërave, e hiperinflacionit dhe autokracisë së Milloseviçit - nuk ka qenë edhe aq e keqe."

MESAZHI NË DESTINACION

Shumë nga pushtetbajtësit e sotëm në Serbi kanë qenë pjesë e regjimit të Milloseviçit, si presidenti Aleksandar Vuçiq. Nacionalisti i dikurshëm radikal ndjek sot zyrtarisht me partinë e tij të progresit një kurs proeuropian, por nga ana tjetër u mbyll gojën mediave kritike dhe opozitës e shpërblen klientelën e partisë së tij me punë në sektorin publik. Ose shpërndan dëftesa rehabilitimi për kriminelët të dënuar lufte. "Që dikush ka kryer dënimin nuk bëhet më pak përgjegjës. Kriminelët e luftës duhet të dëno-

politikë me mitin e popullit të vogël trim, që ka luftuar kundër të gjithë botës. Kjo nuk e çudit Sonja Biserkon. Narrativi se Serbia është vetëm viktimë e luftës është cimentuar ndër kohë, thotë presidentja e degës serbe të Komitetit të Helsinkit. "Drama e Kosovës shihet vetëm nga perspektiva e sulmit irracional të NATO-s. Për vuajtjen dhe viktimat e shumta mes shqiptarëve nuk flitet", thotë Biserko në bisedë me "DW". Por, edhe në anën tjetër gjendja nuk është më e mirë. Në Kosovë protestuan të gjithë politikanët drejtues kundër hapjes së Tribunalit të ri, që do të hetojë krimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku flitet edhe për ngritje akuze kundrejt presidentit Thaçi. Armiqësitë e vjetra theksohen periodikisht dhe elitat politike në Prishtinë e Beograd, kjo i ndihmon për të ruajtur pushtetin.

HOROSKOPI

DASHI

Edhe pse duhet të prisni ndonjë polemikë të provokuar nga Plutoni kundërshtar, do merrni lajme të bukura dhe interesante nga Urani. Do përjetoni një gëzim të madh. Një mik që keni kohë që nuk e keni parë do kthehet tek ju.

DEMI

Dielli, Mërkuri dhe Jupiteri kundërshtarë tek Shigjetari nuk do bëjnë asgjë për t'ju ndihmuar. Përkundrazi, keni tendencën të nxitoheni për çdo gjë. Kini kujdes, duhet të jeni më të përqendruar nëse nuk doni të përballeni me të papritura të pakëndshme.

BINJAKET

Para se të ndërmerri angazhime të reja, vlerësoni mirë sa energji keni në dispozicion për të përmbyllur çështjet e lëna përgjysmë. Mund të gaboni për diçka të rëndësishme, jini më të kujdesshëm dhe të zgjuar.

GAFORJA

Dielli së bashku me Jupiterin do t'ju japin një shans për të përmbyllur dëshirat tuaja, duke i dhënë botës suaj emocionale një kthesë të dobishme. Hakmarrja ndaj një personi që shpesh ju ka prishur planet do t'ju bëjë të fitoni vetëbesimin.

LUANI

Ndryshimet në horizont keni kohë që i prisni dhe tani ka ardhur momenti. Jepini atyre hapësirë në ekzistencën tuaj, vazhdoni me vendosmëri. Nëse jeni beqar, kini më tepër besim tek njohtet e reja. Çiftet do jenë në harmoni të plotë.

VIRGJERESHA

Me Neptunin kundër, do keni nevojë t'i përkushtoheni vetes, ndoshta duke gjetur pak kohë për pushime të shkurtra. Mos u besoni premtimeve të parralizueshme, mos humbisni kohë për persona që nuk e meritojnë vëmendjen tuaj.

PESHORJA

Sot do ndjeheni krejtësisht të qetë. Hëna tek Shigjetari ju shtyn drejt aktiviteteve të reja dhe aventurave. Në profesion do t'u përkushtoheni rregullisht dhe në mënyrë metodike angazhimeve të zakonshme.

AKREPI

Po kërkoni për punë? Me Jupiterin në shenjë mund të guxonit për të arritur edhe të pamundurën. Është periudhë e përkryer për të firmosur një kontratë të rëndësishme. Mos e teproni me ankesat për të kompensuar situatat pak të favorshme. Përipiqni të mos konsumoni shumë ushqime.

SHIGJETARI

Duke qenë se Hëna është mike e Venusit, por armiqësore ndaj Neptunit, do ju duket sikur problemet po largohen, por ndjenja e mirëqenies që do pasojë do jetë thjesht një iluzion. Një person i afër ka nevojë për ndihmën tuaj që të qartësojë idetë për një çështje të rëndësishme.

BRICJAPI

Me Marsin negativ, përipiqni të mos kërkoni pretekte të kota për të acaruar gjendjen në shtëpi ose për të shprehur nervozizmin që keni për shkak të punës. Do kaloni mbrëmjen me miqtë e zakonshëm që do jenë për ju një oaz i vërtetë paqeje dhe qetësie.

UJORI

Trekëndëshi i Venusit, Marsit dhe Uranit inkurajojnë në mënyrë të mrekullueshme aktivitetet tuaja në fushën artistike dhe intelektuale. Do arrini rezultate të shkëlqyera në punë, por edhe në një shoqërore.

PESHQIT

Sot do të jeni të zhytur në ëndërrime për shkak të bashkëveprimit të Hënës me Neptunin. Mos u fshihni pas justifikimeve të kota, por mundohuni të gjeni zgjidhje për një problem në familje. Do ju shfaqen mundësi të mira në karrierë ose për të gjetur punë, tregohuni të gatshëm t'i shfrytëzoni si duhet.

Katouica

Nuk bisedohet me Greqinë në këto kushte

(Vijon nga faqja e parë)

Nga Shaban MURATI

... vitet e fundit. Deri tani ndërhyrjet e Greqisë në punët e brendshme të Shqipërisë janë ndërmarrë nën pretekstin e mbrojtjes së interesave të pakicës greke. Por është hera e parë që Ministria e Jashtme e Greqisë në një komunikatë zyrtare ndërhyrje në çështjet e brendshme të jetës politike shqiptare. Komunikata e MPJ të Greqisë në 19 tetor përfaqëson një ndërhyrje të pasqyruar në zhvillimet e brendshme shqiptare dhe kjo dëshmohej me sulmin që nis qysh në paragrafin e parë të saj. Ja komunikata e MPJ të Greqisë e botuar në faqen e saj zyrtare: "Lidhja e dukshme midis krimit të organizuar dhe skenës politike në Shqipëri, siç tregojnë arrestimi i fundit i kreut të një rrjeti të trafikut të drogave, që ndodhi të jetë një kushëri i dukur, i cili deri kohët e fundit ishte ministri kryesor në qeverinë Rama, krijon shqetësime".

Është e pazakontë në praktikën diplomatike midis dy shteteve, që janë anëtare të NATO-s dhe të cilin Shqipëria e ka shpallur aleat strategjik, të ndërhyhet dhe të akuzohet zyrtarisht Shqipëria për lidhjen e krimit të organizuar me skenën politike. Nuk ka se çfarë i duhet MPJ të Greqisë se çfarë ndodh në skenën politike të shtetit tonë, gjë që është problem ekskluzivisht i brendshëm i shtetit tonë. Nuk ka tagër diplomatik MPJ e Greqisë të japë verdikte zyrtare dhe publike mbi "lidhjet e krimit të organizuar me skenën politike shqiptare". Është anormale nga pikëpamja diplomatike që MPJ e Greqisë sulmon me emër kryeministrin e Shqipërisë për anëtarët e kabinetit shqiptar, që ai ka zgjedhur. I ashtuquajtur shqetësim i Athinës për jetën e brendshme politike në Shqipëri është pretendim për rolin e protektorit mbi Shqipërinë.

Ritualli i komunikatave dhe i deklaratave të MPJ të Greqisë me ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë është bërë kaq frenetik nga qeveria Cipras-Kocias sa mund të thuhet se ka numrin më të lartë në krahasim me qeveritë e mëparshme greke. Vetëm në muajin tetor janë dy deklaratatë të MPJ të Greqisë kundër Shqipërisë. Në dy muajt e fundit Presidenti i Greqisë ka dalë tri herë me deklaratatë me ndërhyrje të drejtpërdrejtë në punët e brendshme të Shqipërisë, madje duke sulmuar Shqipërinë dhe Kosovën bashkë. Ky është stili aktual i sjelljes së diplomacisë greke për marrëdhëniet me Shqipërinë.

Ajo që tërhoqi vëmendjen tonë lidhur me komunikatën e 19 tetorit është së pari flagranca e ndërhyrjes në jetën e brendshme politike të Shqipërisë dhe së dyti, koha kur MPJ e Greqisë zgjodhi të shpallë zyrtarisht "shqetësimet" për zhvillimet e brendshme politike në vendin tonë.

Pala greke ka njoftuar se muajin e ardhshëm MPJ e Greqisë dhe MEPJ e Shqipërisë do të zhvillojnë në Kretë të Greqisë bisedime dypalëshe për problemet e pazgjidhura në marrëdhëniet midis dy vendeve. Parimisht është pozitive të krijohen kushtet dhe klima e përshatshme për ato bisedime. A mund të thuhet se ekziston aktualisht kjo klimë dhe a premtim ajo klimë një rezultat pozitiv të bisedimeve të ardhshme? Vështirë të pohohet kjo, pas dy deklaratave ndërhyrëse në punët e brendshme të Shqipërisë, që ka bërë MPJ e Greqisë në 19 dhe në 15 tetor. Veçanërisht deklarata e 19 tetorit 2017 me pretendim për "shqetësimet" greke për çështjet e brendshme të jetës politike shqiptare dhe me një goditje me emër ndaj kryeministrin shqiptar e ka mbushur me hidhura rrugën e bised-

Sugjerimi im për Kryeministrin e Shqipërisë është që t'i shtyjë bisedimet deri në kohën kur Athina të pastrojë retë që ka krijuar dhe kur të demonstrojë vullnetin e mirë për të zgjidhur realisht problemet e pazgjidhura në marrëdhëniet dypalëshe.



imeve dypalëshe të muajit të ardhshëm.

Nuk është shenjë e vullnetit të mirë nga MPJ e Greqisë, zgjedhja e datës 19 tetor për shpalljen e komunikatës së saj, ku ndërhyrje në një çështje të brendshme shqiptare, për të cilën drejtësia e Shqipërisë nuk e ka dhënë ende fjalën e saj. Duke vlerësuar nga një pozicion jomiqësor se qeveria e Shqipërisë ndodhet në një moment të vështirë të brendshëm, diplomacia greke dhe qeveria greke nxitojnë të shfaqen si faktor i jetës politike dhe i zhvillimeve të brendshme në Shqipëri. Ata marrin rolin e palës në jetën e brendshme politike shqiptare, sikur të jenë një forcë politike sh-

hierarkike, me të cilin diplomacia greke dhe qeveria greke do të trajtojnë problemet e pazgjidhura midis dy shteteve. Kjo frymë tregon se i ashtuquajtur mekanizëm dypalësh i zgjidhjes së problemeve të hapura midis dy shteteve, që ministri i Jashtëm grek Kocias e serviri që në vitin 2015 si çelësin magjik të zgjidhjes së problemeve, do të ndjekë fatin e komisionit të famshëm dypalësh, që krijuan në vitin 2004 dy qeveritë për të zgjidhur problemet e hapura midis dy shteteve. Ai komision jo vetëm nuk zgjidhi, por nuk u mbodhi asnjëherë. Tani ka një përparim se komisioni i vjetër quhet nga Kociasi "mekanizëm dypalësh", të cilin diplomacia greke dhe Kociasi e kanë konceptuar si modelim i zgjidhjeve me formulat greke. Mjafton të shohësh kushtet dhe ofertat e tanishme greke, në prag të bisedimeve të ardhshme dypalëshe, për dy çështjet e pazgjidhura të dosjes shqiptaro-greke.

E para është ligji i luftës për të cilin Kocias që në vitin 2015 në Tiranë bëri propozimin absurd që, për hatër të shqiptarëve siç tha ai, ta përfshijë në Traktatin e ri të Bashkëpunimit midis dy shteteve, në një kohë që ai është ligj grek dhe duhet ta abrogojë parlamenti i Greqisë dhe shteti grek. E dyta, është çështja çame, të cilën Kocias e përjashton kategorikisht nga bisedimet jo vetëm si zgjidhje, por edhe si shtrim çështjeje në trezëzën e bisedimeve.

Kërkesa e Shqipërisë duhet të jetë që çështja çame të përfshihet në Traktatin e ri të Bashkëpunimit dhe të Miqësisë midis dy vendeve. Një traktat pa përfshirjen e çështjes çame nuk ka asnjë kuptim dhe nuk do të zgjidhë asnjë problem, ashtu siç nuk zgjidhi edhe traktati i mëparshëm gjatë 20 viteve.

Në prag të bisedimeve, diplomacia greke vazhdon taktikat bizantine për të ofruar 5 dhe për të marrë 95, për të dhënë apostilën dhe për të mos hequr ligjin e luftës dhe efektet e tij negative mbi shqiptarët, për të ofruar sigurimet shoqërore dhe për të marrë plantacione pa fund të varrezave greke në jugun e Shqipërisë, për

të premtuar njohjen e Kosovës dhe për të marrë marrëveshjen e zezë të detit dhe detin shqiptar.

Komunikatat e njëpasnjëshme të MPJ të Greqisë dhe të presidentit grek me ndërhyrje flagrante në punët e brendshme të Shqipërisë, që nga ligji i ndarjes territoriale e deri ligji për pakicat, rivendikimet absurde mbi Përmetin apo Himarën etj. e deri tek deklarata e 19 tetorit, që sulmon direkt qeverinë e Shqipërisë, përbëjnë sinoptikën më të qartë se çfarë moti dhe rezultati po përgatit diplomacia greke për bisedimet dypalëshe të muajit të ardhshëm. Kjo situatë duhet ta bëjë qeverinë e Shqipërisë të mendohet seriozisht.

Luizonet apo infantilizmat e "modernitetit dhe konstruktivitetit", me të cilat është nurrurur (e vetmja në Ballkan) diplomacia shqiptare gjatë 25 viteve, duke i bërë lëshime strategjike Greqisë, nuk mendoj se duhet të jenë filozofi e politikës së jashtme shqiptare në rajon. Pa simetrimin e barazisë, të dinjitetit dhe të respektit të interesave reciproke shtetërore e kombëtare, as mund të mendohet se do të ngrihet guri i Sizifit i problemeve të pazgjidhura deri në majën e fundit të lumtur Zyrave shtetërore vendimmarrëse u mjafton të analizojnë vetëm komunikatën e 19 tetorit të MPJ të Greqisë për të parë se sa e papërshtatshme është të zhvillohen bisedime serioze dypalëshe në këto kushte. Anashkalimi i kësaj situatë do të thotë pranim i nëpërkëmbjes së dinjitetit të shtetit, do të thotë që të shkohet në duel me shpatë të thyer.

Situata të tilla kërkojnë përgjegjësinë e qeverisë, por kërkojnë edhe përgjegjësinë e partive politike shqiptare në opozitë, të cilat duhet të refuzojnë miklimet bizantine, që vijën nga Athina për këtë apo atë pozicion të brendshëm politik. Çështjet e pazgjidhura midis dy shteteve janë interes jetik kombëtar dhe jo partiak dhe kërkojnë konsensusin dhe bashkëpunimin e të gjitha partive politike shqiptare, pavarësisht nga rivalitetet e brendshme midis tyre. Është rasti të kujtoj këtu se kur Silvio Berlusconi ishte kryeministër i Italisë dhe Romano Prodi ishte president i Komisionit Europian në Bruksel dhe mediat britanike ndërmorën një fushatë të ashpër disamujore kundër Romano Prodit, kryeministri Berlusconi u ngrit me forcë në mbrojtje të tij. Kur gazetarët italianë e pyetën Berlusconi pse e përkrahu armikun e tij politik dhe personal, ai u përgjigj: "Romano Prodi në Bruksel është Italia". Në këtë vizion, për interesin kombëtar duhet të bashkohen edhe partitë politike shqiptare në politikën e jashtme të Shqipërisë me njërin apo tjetrin shtet fqinj.

Diplomacia greke nuk ka krijuar kushte normale për bisedimet e ardhshme dypalëshe midis dy shteteve:

- Ka një ndërhyrje frenetike të pashembull në jetën e brendshme politike dhe përpjekje greke për t'u bërë palë politike në Tiranë. Qeveria duhet të ketë kaq djepi sa të kuptojë se kjo ndërhyrje është pjesë e strategjisë së Athinës për ndryshim regjimi në Shqipëri, e afishuar nga diplomacia greke që në vitin 2015.

- Ka një sulm direkt për qeverinë e Shqipërisë.

- Nuk ka asnjë sinjal fleksibiliteti për çështjet kardinale historike të pazgjidhura midis dy shteteve.

- Ka një shtim të kërcënimit publik të shtetit grek mbi Shqipërinë për vendosjen e vetos në BE kundër hapjes së bisedimeve europiane me Shqipërinë.

Në këto kushte pabarazie, sugjerimi im për Kryeministrin e Shqipërisë është që t'i shtyjë bisedimet deri në kohën kur Athina të pastrojë retë, që ka krijuar dhe kur të demonstrojë vullnetin e mirë për të zgjidhur realisht problemet e pazgjidhura në marrëdhëniet dypalëshe.

TIFOZËT VLONJATË PROVOKOJNË DUKËN



Mesazhi: Pulat kakarisin vetëm në kotec

Teksa luhej sfida mes Flamurtarit dhe Kamzës, në shkallët e stadiumit është shfaqur një banderolë nga tifozët vlonjatë, duke bërë kështu një ironi me presidentin e FSHF-së, Armando Duka. Në mesazhin e nxjerrë nga tifozët e Flamurtarit, shkruhej: "Pulave u ka hije të kakarisin në kotec". Ngjarja e cila ndodhi në minutën e 53-të nuk u tolerua nga arbitri kryesor, Remzi Sadiku, i cili ndërpreu ndeshjen deri në heqjen e banderolës.

NA THYEN SPANJA



E pësojmë në fund, Shqipëria U-17 eliminohet

Shqipëria U-17 nuk ia ka dalë të marrë rezultat ndaj Spanjës, ekip favorit për të kaluar në raundin tjetër të kualifikueseve të Europianit. Kuqezinjtë e drejtuar nga Xhemal Mustedaganiç janë mposhtur në fund me rezultatin minimal 0-1, sikurse ndodhi në ndeshjen e parë me Kroacinë. Kapiteni i Spanjës, Zoubdi, ishte ai që vendosi fatin e ndeshjes me golin e shënuar në minutën e 77-të, tri minuta para fundit. Me këto dy humbje minimale elimino-hemi, ndërkohë që ndeshja e fundit e Lihtenshtejnin ka vlerë statistikore, pasi luhet vetëm për vendin e tretë.

Vendos goli i Milan Basrak. Në Vlorë kuqezinjtë festojnë me 'kokën' e Bicajt, që thyen Kamzën



Jeton Selimi

Partizani nuk ndalet më, Flamurtari gdhin i treti

Të kuqtë dalin duarplot nga "Loro Boriçi"

Partizani fiton të tretën radhazi dhe duket se ka shkëlmuar njëherë e mirë krizën e fillim sezonit. Ndonëse fitorja nuk erdhi me një lojë të bukur, e rëndësishme për kryeqytetasit ishte marrja e tri pikëve, shumë të nevojshme për të besuarit e Julianos, të cilët tanimë vihen në ndjekje të Kukësit dhe Skënderbeut.

Dhe nis gjithçka mirë në "Loro Boriçi" për miqtë, kur Milan Basrak, serbi që luante të parën si titullar me fanellën e kuqe, godet me kokë dhe çon topin në rrjetën e Selimajt që në minutën e katërt. Vllaznia përpqet të reagojë në minutën e 15-të, por Oresli nuk arrin të devijojë harkimin e Gilman Likës. Në të 24'-ën kemi një goditje dënimi në krahun e majtë të mesfushës për Vllazninë, krosron Lika, por grushton Alban Hoxha duke larguar rrezikun. Pjesa e parë mbyllet me Partizanin në sulm, ku Lorenc Trashi krosron bukur drejt zonës për Adrojan, por hungarezi nuk arrin të devijojë drejt portës. Pjesa e dytë nis me Partizanin në mbrojtje të rezultatit dhe me Vllazninë, që e ka të vështirë të gjejë hapësira. Gilman Lika provon dy herë radhazi kuadratin e Hoxhës, por e para është qendrore, ndërsa të dytën gardiani i kuq do ta ndalë në dy kohë. Në minutën e 65-të tifozët e Partizanit braktisin stadiumin pas një ndërhyrjeje të pakuptimtë të policisë në një takim që po shkonte mirë në çdo aspekt, ndërsa u vu re dhe prezenca e shtuar e skafandrave të FNSH-së në sektorin e kuq. Në minutën e 71-të është Trashi, që provon ta vendosë në vështirësi Selimajn me një gjuajtje nga goditja e dënimit, por është i vëmendshëm gardiani shkodran. Të kuqtë shkojnë drejt një suksesi të merituar, të cilin nuk e trondit as gjuajtja e Bardullës në minutën e 92-të, ndërsa kryeqytetasit rikthehen në shtëpi me 3 pikë në xhep. Gjoka nga ana tjetër duhet të gjejë patjetër ilaçin për ta rikthyer Vllazninë në shinat e duhura.

SUPERLIGA	
JAVA E 7-të	
TË SHUTUNËN	
Luftëtari - Kukësi	0-3
Lushnja - Laçi	0-3
TË DIELËN	
Vllaznia - Partizani	0-1
Flamurtari - Kamza	1-0
TË HËNËN	
Teuta - Skënderbeu	17:00



NË VLORË

101 minuta për të marrë tri pikë! Flamurtari thyen Kamzën, me të cilën bashkëjetonte në vendin e tretë dhe lë pas pikërisht skuadrën e Ramadan Ndreut dhe Partizanin. Heroi i ndeshjes është Ditmar Bicaj, që me golin e sotëm u vë kapak situatave që ka pasur

kundër në këtë fillim-kampionati. Ka shumë arësyë për të qenë i kënaqur Shpëtim Duro, që vjen në Tiranë i qetë javën e ardhshme, ku e pret Partizani i tij. Momenti i parë i rrezikshëm në këtë takim do të vijë në minutën e 20-të. Danilo Alvesh ekzekutoi një goditje dënimi duke tentuar portën, por

topi grushtohet nga Halilaj. 9 minuta më pas Fukui do të shënojë për miqtë, por kryesori Sadiku ndal lojën për një faull ndaj Nurkoviçit. Në minutën e 44-të është sërish braziliani Alvesh që provon nga jashtë zonës, por topi del sipër traut. Edhe pjesa e dytë nis me Alveshin në kërkim të

golit, por në minutën e 49-të Halilaj tregohet i vëmendshëm dhe grushton në këndore. Në minutën e 65-të tenton Neziraj për miqtë, por nuk ka koordinatat e duhura, ndërsa nga minuta e 67 deri në të 72-ën kemi "black-out" në stadium, me ndeshjen që rifillon vetëm pas rikthimit të energjisë. Në të 77'-ën provon sërish Neziraj, edhe njëherë jashtë. Kur ndeshja po i drejtohej barazimit në zhvillimet e një këndoreje, Ditmar Bicaj kërcën me shumë se të gjithë dhe me kokë shënon golin e fitores për vendësit. Gol që nuk u cenua as nga shtesa tejet e gjatë e Sadikut, me vlonjatët që rikthehen te fitorja pas tri barazimeve radhazi dhe me kamzalinjtë, që humbasin pas dy fitoreve radhazi.

BONUÇI TRADHTON MILANIN



Berisha triumfon, humbasin Gjimshiti dhe Memushaj

Milani harron të fitojë. Kuqezinjtë zhgënjyen sërish këtë herë në ndalën në një barazim pa gola nga Xhenoa brenda në "San Siro". Një ndeshje që u kush-tëzua nga veprimi i kapitenit Bonuçi, i cili në mesin e pjesës së parë goditi me bërryll Rosin me gjuatjarin Xhakomeli, që i ndihmuar edhe nga ndërhyrja e VAR-it e ndëshkoi me karton të kuq ish-mbrojtësin e Juventusit, duke lënë me 10 lojtarë në fushë Milanin. Stoli i Vinçenzo Montelës vazhdon të lëkundet, me pozicionin e trajnerit, që është në dyshim të madh pas këtij tjetër hapi fals. U rikthye te fitorja Roma, që iu fal këmbëve të serbit Kolarov për të mposhtur 0-1 Torinin në transfertë. Ashtu si në javën e parë ndaj Atalantës, edhe këtë herë Kolarov ekzekutoi në mënyrë perfekte një goditje standarde për t'i dhënë tri pikët skuadrës verdhekuqe. Paraqitje e mirë e Etrit Berishës, që nuk pësoi gol në fitoren 1-0 të Atalantës ndaj Bolonjës. Fiorentina kaloi 3-0 Beneventon në transfertë me Gjimshitin e Memushajin, të cilët ishin titullarë, ndërsa Sasuolo mposhti jashtë fushe 1-0 Spal-in.

BUNDESLIGA

Frajburgu i Abrashit, barazim me Hertën

Ndihen me nga një pikë të dyja sfidat e javës së 9 të Bundesligës gjermane, Këln-Verder Bremen e përfunduar me shifrat e barabarta 0-0, me të dyja skuadrat që ndodhen në zonën e ftohtë të renditjes. Po ashtu, edhe 1 pikë për sfidën tjetër midis Frajburgut dhe Hertës së Berlinit, që përfundoi me barazimin 1-1. E para në avantazh kaloi skuadra e Abrashit në minutën e 52 me autor Haberer, më pas skuadra kryeqytetase e Hertës së Berlinit reagoi duke barazuar shifrat në 1-1 me një 11-metërs nga Salomon Kalu në minutën e 81. Kjo pikë nuk është se i kënaq të dyja skuadrat, sepse ndodhen në një moment të vështirë.




ANGLI

Totenhemi, poker golash në portën e Liverpoolit



Pas barazimit 1-1 me Realin e Madridit në Champions, tashmë Totenhem tregon përsëri forcën e ekipit, duke fituar bindshëm 4-1 ndaj Liverpoolit. Dy herë Kejn, Son dhe Dele Ali, shënuan katër herë ndaj skuadrës së Klop dhe zhvlerësuan golin e vetëm nga të kuqtë, që u shënuan prej Salah. Tashmë Totenhem ngjitet në vendin e dytë, me 20 pikë, po aq sa Manchester Junajtid, të cilat ndjekin Sittin e Guardi-olës, që numëron 5 pikë më shumë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Ferguson trainer.
- Grand Prix
- Eshhtë stacion beudini.
- Një artikull jo për vejetarian.
- Kujti i vjen... di të bëjë.
- Kaçaturian kompozitor
- Logot pa kujfi
- Parashtesë për vetë.
- Aktorja protagoniste e Vertigo.
- Ndezur në aparat.
- Eshhtë si teofilim.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Eshhtë me shumë se kërkesë.
- Cristiano bomber të Real Madrid.
- Teket e grave.
- Në krye të masave.
- Shkon goja... nga nepsi.
- Duken të gjata ato të pritjes.
- Gjysmë bataku.
- Eshhtë për medaljen e parë

- Eshhtë kujdesi i babait.
- Maiden që këndojnë.
- Një "bombë" tenisistike.
- Fillojnë mykjen
- Janë këngëtarët si Jose Carreras
- Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
- Lumë në Francë.
- Piktori i Ura e Narnit.
- Kapen në kufij

VERTIKAL

- Në hyrje të ambientit
- Neeson aktor.
- Ente Sociale Rumune.
- Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
- Kufizojnë stacionin.
- Tremb fëmijët.
- Jepet për t'u marrë.

- Qytet japonez.
- Eshhtë pemë
- Janë tallësit.
- Roberto trainer italian.
- Freni këngëtare lirike.
- Gjysmë totale.
- Një si divan.
- Tipare pa zë
- Ulet në dhomën e lartë.
- Moore aktor.
- Qe bomber brazilian.
- Ishte shpërthimi i Little Boy.
- Carolina, e bukura e Belle epoqe.
- Mbarojnë fare
- Pullman aktor.
- Eshhtë thëllimi
- Meg aktore.
- Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- Një lidhëz.
- Kaluar në krye.
- Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Mund të hidhet të kiromanti
- Teket e kafes.
- D'Istria e Helena Gjikkës
- Smith filozof.
- Kuke regjisor
- Një pjesë e minoritetit.
- Moduli i Neil Armstrong.
- Mund të jenë qitjeje.
- Markë pistolette.
- Mbylli fushatat.
- Eshhtë dorëzim.
- Eshhtë detar.
- Fillojë ilustrimet.
- Eshhtë hon.
- Diftong në duel
- Një pjesë e rifillimit.
- Një që kuron karien.
- Nganjëherë duhen vënë mbi.
- Egër dhe e fortë.

VERTIKAL


- E famshme ajo maqedonase.
- Një zakon.
- Bejnë alarm me ar
- Inicialet e Mallë regjisor
- Mund të jetë telefonike
- Ka dy faqe
- Mund të jetë një cutter.
- Në mes të dhomës.
- Mbahet me bateri.
- Përfshijnë edhe Haitin.
- Denis i enëve me presion.
- Paguhen për shërbime.
- Janë ufo.
- Ekstremit në tunel.
- Një atentator vetëvrasës.
- Markë cigaresh.
- Arrihet duke mundur.
- Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
- Eshhtë aparati me zorrë.
- Pak servilizëm.
- Kështu e ka syrin vigjilenti.
- Fatih trainer turk.
- Nostra me mafiozët.
- Mbyllin punimet.
- Ai i shenjtë është papa.
- Kufizojnë në teknik.
- Fillojnë panikun.
- Fund tuneli.
- Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4		9				7			5
	2	1		3		4	6		
2			1		3				9
		5				1			
3			7		5				6
	7	2		6		3	9		
1		3				8			4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	9	1	3	5	2	8	7
1	7	5	2	9	8	6	4	3
8	3	2	7	6	4	1	9	5
9	5	8	4	1	3	7	2	6
3	4	7	6	8	2	5	1	9
6	2	1	5	7	9	8	3	4
7	8	4	9	5	1	3	6	2
2	1	6	3	4	7	9	5	8
5	9	3	8	2	6	4	7	1

Argëtim filozofik

"Mik i mirë është ai që di gjithçka për ty dhe megjithatë vizon së qeni miku yt".
Elbert Hubbard

Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjënë në gjithçka! (Giacomo Leopardi)

A s'e sheh që luani rri i heshtur, por nga ai të gjithë janë të frikësuar, e qeni leh pa ndalë por prapë është i përçmuar. Imam Shafiu

Të të duan thëllësisht - të jep forcë; të duash thëllësisht - të jep qum! Lao Tzu

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3		11	5	9	6	11	1	4	3	
12	16	15	17	6	11		15	4		12	2	
6		1	4	12	6	11	5	18	11	2	9	
17	18		5	4	12	6	1	4	14	2	3	
2			1	7	3	2	9	7	9	2	3	
	14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3	
18	4		6	9	8		4	12		7	9	
	9	2	12	2	4		12	3	9	2	18	
4	8		2	3		8	6	6		6	16	15
5	4	12	3		11	2	5			3	6	12
15	3	6		1	2	3	4		3	2	11	2
17	9	9	15	16	4		4	9	3	2	3	

E	P	O	S		M	P	L					
R	E	T	E		V	A	R	I	A	N	T	
E	L	I			T	E	N	I	S	T	E	T
N	E		K	A	P	I	T	U	L	L	I	
D			M	I	U	R	A		S	E	S	
E	A		L	L	A	K	U		T	O	T	
			K	A	M	A	T	E		I	N	O
A	S		A	N	T	E	T		T	K	P	
V			A	R	T	I		I	R	A	N	I
A	L		T		E	M	I	L	E	D		
R	O		J	E	T		K	E	N	D	E	T
I	N		E	S		P	A		I	N	R	I

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mëncura

- Ne nuk jetojmë, thjesht shpresojmë të jetojmë, duke pritur gjithnjë lumturinë në të ardhmen, ndaj është e pashmangshme që s'do të jemi asnjëherë të lumtur. (Blez Paskal)
 - Një njeri s'mund të ndihet realisht mirë, në rast se nuk aprovon vetveten. (Mark Tuijn)
 - Nga diamantet nuk lind asgjë, nga dheu lindin lulet.
 - Askush nuk mund të emancipohet nëse nuk emancipon njëherazi të gjithë ata që ka rrotull.
 - Ç'është koprracia? Eshhtë të jetosh në varfëri nga frika se mos bëhesh i varfër.
- Samuel Bernard Financier (1651-1739)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Korça

KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA

Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon

Sherri për katërbë, Rosa Lali: Do t'i jap kastrovece Rezari Veselshija i "Partitokallise" ndahet nga e fejuara

Tashmë edhe lundroni!

